

# Migracioni i kthimit dhe ri-integrimi në SHQIPËRI

2013



# Migracioni i kthimit dhe ri-integrimi në SHQIPËRI

2013



Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (ONM). Emërtimet e përdorura dhe paraqitja e materialit në këtë raport nuk nënkuptojnë shprehjen e asnjë opinioni nga ana e ONM në lidhje me statusin ligjor të ndonjë vendi, territori, qyteti ose zone, ose të autoriteteve të tij, ose në lidhje me kufijtë e tij.

ONM është e përkushtuar ndaj parimit se migracioni njerëzor dhe i rregullt është në përfitim të migrantëve dhe shoqërisë. Si një organizatë ndërqeveritare, ONM bashkëpunon me partnerët e saj në komunitetin ndërkombëtar: për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve aktuale të migracionit; për të çuar përpara të kuptuarit e çështjeve të migracionit; inkurajuar zhvillimin social dhe ekonomik nëpërmjet migracionit; dhe mbrojtur dinjitetin njerëzor dhe mirëqenien e migrantëve.

Organizata Ndërkombëtare për Migracionin dëshiron të falënderojë Fondin e Zhvillimit të ONM për mbështetjen financiare për hartimin dhe botimin e këtij studimi.

Ky publikim nuk është edituar nga IOM.

## **BOTUES:**

### **INSTITUTI I STATISTIKAVE**

Blv. "Zhan D'Ark" Nr.3, Tiranë  
Tel: + 355 4 2222411 / 2233356  
Fax: +355 4 222830  
E-mail: info@instat.gov.al  
Website: <http://www.instat.gov.al>

### **ORGANIZATA NDERKOMBETARE PER MIGRACIONIN**

Misioni në Shqipëri  
Rruga "Ibrahim Rugova", Nd. 42, H.12, Apt.4  
Tiranë, Shqipëri  
Tel: +355 4 2257836-7; Fax: +355 4 2257835  
E-mail: [infotirana@iom.int](mailto:infotirana@iom.int)  
Website: <http://www.albania.iom.int>

## **EMRAT E AUTOREVE**

### **INSTAT**

Gjergji Filipi  
Emira Galanxhi  
Majlinda Nesturi


### **IOM**

Teuta Grazhdani

Copyright

©INSTAT dhe Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (ONM), 2014

ISBN: 978-9928-188-13-7

Shtypshkronja:  Gent-grafik

  
Republika e Shqipërisë  
Instituti i Statistikave

  
International Organization for Migration (IOM)  
Organisation internationale pour les migrations (OIM)  
Organización Internacional para las Migraciones (OIM)



## PARATHËNIE DHE FALENDERIME

Vrojtimi mbi "Migracionin e kthimit dhe ri-integrimi në Shqipëri, 2013" vjen falë një bashkëpunimi të frytshëm mes Institutit të Statistikave të Shqipërisë (INSTAT) dhe zyrës së Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM). Ky studim i cili analizon karakteristikat kryesore të fenomenit të migracionit të kthimit dhe ri-integrimit të emigrantëve të kthyer është i pari në llojin e tij i bërë në Shqipëri. INSTAT dhe IOM kanë kryer këtë studim të thelluar me synimin për të përfituar një panoramë sa më të plotë në lidhje me fenomenin e kthimit të emigrantëve pas krizës ekonomike dhe financiare të vitit 2009. INSTAT dhe IOM u bashkuan për të ndërmarrë një vërtetim kombëtar jo vetëm për të matur më mirë fenomenin e migracionit të kthimit në Shqipëri por dhe për të orientuar shërbimet që ofrohen për ri-integrimin e të kthyerve. Nëpërmjet këtij vërtetimi synohet të hidhet dritë mbi faktorët e ndryshëm që ndikojnë në ri-integrimin e tyre në Shqipëri. Studimi i kryer përmes një vërtetimi kombëtar të realizuar në periudhën në shtator-tetor 2013, sugjeron se fenomeni i kthimit të emigrantëve është në përmasa të konsiderueshme, sidomos pas vitit 2009 dhe për rrjedhojë adresimi i problematikave dhe ri-integrimi i emigrantëve janë sfida për vetë shoqërinë shqiptare. Ndaj shoqëria civile, politikëbërësit, organizatat ndërkombëtare apo strukturat administrative lokale dhe qendrore, komuniteti akademik e universitar do të kenë në dorë një instrument të volitshëm për të kuptuar problematikën e migracionit duke kontribuar në qasje efikente për ri-integrimin e emigrantëve në shoqëri.

Falenderimet dhe mirënjohje e veçantë shkon për iniciatorët e këtij studimi, Zyrën e Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) si dhe të gjithë bashkëpunëtorët e INSTAT, të cilët kanë kontribuar në realizimin e këtij studimi.

Dr. Gjergji FILIPI

Drejtor i Përgjithshëm i INSTAT



## PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	9
<b>1. HYRJE</b>	<b>11</b>
Informacion paraprak për vrojtimin	13
Objektiva të vrojtimit	13
Struktura dhe përmbajtja e raportit	13
<b>2. GJETJE NGA STUDIMI I LITERATURËS</b>	<b>15</b>
Vështrim i përgjithshëm i migracionit të kthimit	17
Faktorë që ndikojnë tek ri-integrimi	17
Migracioni i kthimit në kontekstin shqiptar; të dhëna nga kërkimi në terren	18
Rrugët e ri-integrimit në Shqipëri	19
<b>3. METODOLOGJIA E VROJTIMIT NË TERREN</b>	<b>21</b>
Pyetësor me tre faza	23
Përgatitja e vrojtimit	24
Plani i kampionimit dhe njësitë e kampionimit	25
Vlerësimi dhe analizimi i të dhënave	26
<b>4. GJETJE NGA VROJTIMI NË TERREN</b>	<b>27</b>
Karakteristikat socio-demografike	29
Gjendja civile e të kthyerve	30
Lloji i kthimit dhe vendi i fundit i destinacionit	30
Përbërja familjare përpara largimit jashtë vendit, në vendin pritës dhe pas kthimit	31
Situata e strehimit	32
Qarqet e qëndrimit të të kthyerve përpara migrimit dhe pas kthimit	33
Të kthyerit sipas numrit të viteve që kanë jetuar jashtë vendit dhe lëvizshmërisë së tyre	34
Vendet kryesore të destinacionit për emigrantët shqiptarë dhe kohëzgjatja mesatare e qëndrimit jashtë vendit	35
Arsyet kryesore të emigracionit	36
Zhvillimi i situatës së punësimit gjatë ciklit të migracionit	37
Punësimi sipas sektorit gjatë migracionit dhe pas kthimit	40
Niveli arsimor	41
Formim profesional	41



Burimet e të kthyerve: kapitali social dhe financiar	42
Përvoja e migracionit përpara kthimit	46
Kthimi në Shqipëri dhe modelet e ri-integrimit	50
Kushtet dhe perspektiva pas kthimit	50
<b>5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME</b>	<b>55</b>
<b>6. BIBLIOGRAFIA</b>	<b>59</b>
<b>7. ANEKSE</b>	<b>63</b>
Aneks 1. Fjalorth	65
Aneks 2. Profili i të kthyerit	66



## Lista e Tabelave

Tabela 1. Shpërndarja e Kampionit ZE dhe Individëve sipas Qarkut dhe zonës urbane/rurale	26
Tabela 2. Të kthyerit shqiptarë sipas grupmoshës	29
Tabela 3. Ndryshimi i gjendjes civile të të kthyerve shqiptarë gjatë itinerarit të migracionit, (%)	30
Tabela 4. Shqiptarët e kthyer sipas llojit të kthimit dhe moshës mesatare, (%)	30
Tabela 5. Të kthyerit sipas vendit të fundit të emigracionit, (%)	31
Tabela 6. Përbërja familjare e të kthyerve shqiptarë pasi largohen nga vendi, në vendin e fundit të emigracionit dhe pas kthimit, (%)	32
Tabela 7. Situata e strehimit të të kthyerve shqiptarë përpara emigrimit dhe në vendin e fundit të emigracionit, (%)	32
Tabela 8. Statusi i akomodimit në vendin e fundit të emigracionit, me mbërritjen e tyre dhe vetëm përpara kthimit të tyre, (%)	32
Tabela 9. Arsytet e emigracionit, (më shumë se një alternativë)	36
Tabela 10. Zhvillimi i situatës së punësimit gjatë ciklit të migracionit, (%)	38
Tabela 11. Të kthyerit sipas statusit të punësimit dhe periudhës së kërkimit të punës, (%)	40
Tabela 12. Punësimi sipas sektorëve të industrisë, (%)	40
Tabela 13. Niveli arsimor i migrantëve përpara largimit dhe gjatë migracionit, (%)	41
Tabela 14. Formimi profesional i të kthyerve, (%)	41
Tabela 15. Përdorimi i remitancave, (më shumë se një alternativë)	44
Tabela 16. Arsyet për të mos bërë asnjë investim, (më shumë se një alternativë)	45
Tabela 17. Vështirësitë e hasura nga të kthyerit që kanë investuar në vendin e tyre, (më shumë se një alternativë)	46
Tabela 18. Shpeshësia e kontakteve me familjarët gjatë vitit të fundit të qëndrimit jashtë vendit, (%)	46
Tabela 19. Shpeshësia e udhëtimit për në vendin e origjinës gjatë vitit të fundit të qëndrimit jashtë vendit, sipas arsyeve, (%)	47
Tabela 20. Arsytet e kthimit për ata që vendosin vullnetarisht, (më shumë se një alternativë)	49
Tabela 21. Perceptimi i të kthyerve për përvojën jashtë vendit sipas gjinisë, (%)	50
Tabela 22. Perceptimi i të kthyerve për përvojën jashtë vendit sipas grupmoshës, (%)	50
Tabela 23. Të kthyerit sipas synimit për të qëndruar në Shqipëri, (%)	51
Tabela 24. Problemet e hasura pas kthimit në Shqipëri, (më shumë se një alternativë)	51
Tabela 25. Perceptimi i të kthyerve për masat e marra për të lehtësuar kthimin në Shqipëri, (%)	51
Tabela 26. Të kthyerit që kanë marrë mbështetje (më shumë se një alternativë)	52
Tabela 27. Lloji i ofruesit të shërbimit të marrë, (më shumë se një alternativë)	52
Tabela 28. Kontaktet e të kthyerve me Sportelet e Migracionit, (%)	52
Tabela 29. Lloji i mbështetjes të marrë nga Sportelet e Migracionit, (%)	52
Tabela 30. Informimi i të kthyerve për Sportelet e Migracionit sipas vitit të kthimit, (%)	53
Tabela 31. Arsytet për ri-emigrim, (më shumë se një alternativë)	54





## Lista e Figurave

Figura 1. Të kthyerit shqiptarë sipas grupmoshës dhe gjinisë, (%)	29
Figura 2. Të kthyerit sipas vitit të kthimit, (%)	31
Figura 3. Të kthyerit sipas vendit të kthimit, (%)	33
Figura 4. Qarqet e qëndrimit përpara migracionit dhe pas kthimit, (%)	33
Figura 5. Përqindja e migracionit të kthimit sipas qarkut, (%)	34
Figura 6. Të kthyerit sipas numrit të viteve që kanë jetuar jashtë vendit dhe lëvizshmërisë së tyre	35
Figura 7. Vendet e emigracionit dhe kohëzgjatja mesatare e qëndrimit, (%)	36
Figura 8. Arsyet e emigracionit sipas gjinisë, (%)	37
Figura 9. Ecuria e statusit të punësimit, (%)	38
Figura 10. Ecuria e statusit të punësimit, femra, (%)	39
Figura 11. Ecuria e statusit të punësimit, meshkuj, (%)	39
Figura 12. Situata financiare e të kthyerve përpara largimit jashtë vendit, (%)	42
Figura 13. Situata financiare e të kthyerve në Shqipëri në vendin e fundit të emigracionit, (%)	42
Figura 14. Situata financiare e të kthyerve pas kthimit krahasuar me atë jashtë vendit, (%)	43
Figura 15. Shpeshtia e remitancave për familjarët gjatë vitit përpara kthimit, (%)	43
Figura 16. Shuma e parave të dërguara në vendin e origjinës një vit përpara kthimit, (%)	44
Figura 17. Projekte investimi të realizuara nga të kthyerit në Shqipëri, (%)	45
Figura 18. Burimet kryesore të mbështetjes financiare për projekte investimi (më shumë se një alternativë)	46
Figura 19. Kontakti me autoritetet shqiptare diplomatike ose konsullore gjatë qëndrimit jashtë vendit dhe arsyet, (%)	47
Figura 20. Shpeshtia e udhëtimit në vendin e origjinës gjatë vitit të fundit të qëndrimit jashtë vendit, (%)	48
Figura 21. Migrantët shqiptarë të kthyer së bashku me familjarët e tjerë, (%)	48
Figura 22. Arsyet e kthimit sipas gjinisë, (%)	49
Figura 23. Informacion për SM sipas vendit të emigracionit, (%)	53
Figura 24. Të kthyerit sipas synimit për qëndrim në Shqipëri, (%)	54



## AKRONIME DHE SHKURTIME

<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>IOM</b>	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
<b>INSTAT</b>	Instituti i Statistikave
<b>KE</b>	Komisioni Evropian
<b>MB</b>	Mbretëria e Bashkuar
<b>MPB</b>	Ministria e Punëve të Brendshme
<b>MMSR</b>	Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë
<b>MPÇSSH</b>	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
<b>MPJ</b>	Ministria e Punëve të Jashtme
<b>OJF</b>	Organizatë Jo-fitimprurëse
<b>OKB</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara
<b>SHBA</b>	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
<b>SHKP</b>	Shërbimi Kombëtar i Punësimit
<b>SKM</b>	Strategjia Kombëtare për Migracionin
<b>PKK</b>	Pikë e kalimit kufitar
<b>PKVM</b>	Plani Kombëtar i Veprimit për Migracionin
<b>SM</b>	Sportel Migracioni
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave
<b>ZRP</b>	Zyrë Rajonale e Punësimit
<b>ZVP</b>	Zyrë Vendore e Punësimit



## PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Emigracioni ka qenë një nga arsyt kryesore të rënies së numrit të popullsisë në Shqipëri gjatë periudhës midis dy censuseve 2001 dhe 2011. Meqë emigrantët shqiptarë nuk janë regjistruar në mënyrë sistematike kur janë larguar nga vendi dhe për shkak se ka pasur vetëm pak arsye për të regjistruar largimin e tyre pranë autoriteteve vendore, përdorimi i “metodave indirekte” ka qenë mënyra e mundshme për të bërë një vlerësim të individëve që kanë emigruar ndërmjet viteve 2001 dhe 2011. Emigracioni në Shqipëri ka qenë fenomen i zakonshëm i cili është ndërmarrë në shumicën e rasteve më shumë nga meshkujt, megjithatë dallimet gjinore në periudhën e fundit të censusit 2001-2011 nuk janë shumë të theksuara. Sipas vlerësimeve indirekte të INSTAT gjatë kësaj periudhe rreth 481.000 shqiptarë janë larguar nga vendi dhe 243.000 prej tyre kanë qenë meshkuj. Sipas të dhënave të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, vendet e destinacionit më të preferuara për emigrantët shqiptarë kanë qenë Italia dhe Greqia, të ndjekura nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), Mbretëria e Bashkuar (MB), dhe Gjermania. Italia është vendi i destinacionit më i preferuar me 47 përqind të emigrantëve, i ndjekur nga Greqia me 43 përqind të emigrantëve shqiptarë, dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) vijjnë si vend destinacioni i tretë.

Sa i përket kthimit, të dhënat e Censusit të Popullsisë dhe Banesave 2011, tregojnë që rreth 139.827 shqiptarë janë kthyer në Shqipëri në periudhën 2001-2011, kryesisht meshkuj. Të kthyerit janë relativisht të rinj dhe në moshë pune. Në terma numerike, arsyt familjare dhe të punësimit dominojnë mes arsyeve të kthimit; kryesisht papunësia është arsyeja dominuese për meshkujt dhe arsyt familjare janë arsyeja dominuese e kthimit të femrave. Ndërsa disa nga këta individë kthehen në Shqipëri për të mos u larguar më, për shumë prej tyre kthimi është i përkohshëm (Maroukis dhe Gemi 2013). Në këtë kuptim, migracioni i kthimit i kapur në census është një foto çasti e migracionit të vazhdueshëm qarkullues (INSTAT, 2014).

Ky raport studimi jep një vështrim të përgjithshëm të migracionit të kthimit në Shqipëri në vitin 2013 dhe dinamikat e ri-integrimit. Raporti është përgatitur në bazë të gjetjeve të një vrojtimi kombëtar që u ndërmor nga Instituti i Statistikave (INSTAT) dhe Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), si edhe në bazë të të dhënave dytësore të mbledhura nga arkivat dhe dokumentet zyrtare. Vrojtimi kombëtar përfaqëson përpjekjen e parë kërkimore për të matur migracionin e kthimit në Shqipëri pas krizës financiare botërore të vitit 2009 dhe për të analizuar ndikimin e krizës tek kthimet në Shqipëri. Raporti hedh dritë në heterogjenitetin që karakterizon kategoritë e të kthyerve duke analizuar nevojat e tyre përkatëse në Shqipëri dhe faktorët e ndryshëm që i japin trajtë modeleve të ri-integrimit të të kthyerve. Censusi i fundit i popullsisë dhe banesave u përdor si kuadër për të ndërtuar një kampion përfaqësues (rreth 2000 individë) të vrojtimit për të gjithë vendin. Një pyetësor i strukturuar u përdor për mbledhjen e të dhënave në lidhje me situatën e individëve përpara largimit nga Shqipëria, për përvojën jashtë vendit dhe për kushtet pas kthimit. Produkt specifik i vrojtimit ishte dhe përgatitja e profilit të një të kthyeri në Shqipëri.

Sa i përket kthimit, nga vrojtimi rezultojnë që gjithsej 133.544 migrantë shqiptarë të moshës 18 vjeç dhe sipër janë kthyer në Shqipëri në periudhën 2009-2013, prej të cilëve 98.414 meshkuj dhe 35.130 femra. Kjo është një diferencë e madhe në raportin e të kthyerve sipas gjinisë, ku meshkujt janë të mbi-përfaqësuar krahasuar me femrat, 73.7 % dhe 26.3% përkatësisht. Që prej vitit 2009 është vënë re një tendencë në rritje e kthimeve, ndërsa shumica e kthimeve kanë ndodhur në vitin 2012 dhe 2013 (53.4 përqind). Kthimet, ku dominojnë kthimet vullnetare (94 përqind) kanë ndodhur nga Greqia, 70.8 përqind, të ndjekura nga Italia 23.7 përqind dhe vende të tjera si Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, etj. Prandaj mund të argumentohet që kthimet në Shqipëri janë kryesisht pasojë e krizës financiare botërore të vitit 2009 që goditi tregun e punës në vendet kryesore të destinacionit për migrantët shqiptarë. Megjithatë, vrojtimi nuk mundi të tregojë nëse kriza ka ndikuar në lëvizshmërinë për punë të migrantëve shqiptarë, përveç mbledhjes së disa të dhënave të kufizuara që mungesa e mundësive për ri-integrim në Shqipëri mund të shërbejë si faktor shtytës për ri-emigrimin e të kthyerve.

Gjetjet e vrojtimit tregojnë që arsyt kryesore për emigracionin nga Shqipëria kanë qenë papunësia në vend dhe mundësi më të mira punësimi jashtë vendit së bashku me mundësi për të ardhura më të larta. Nuk ka dallim të madh gjinor tek arsyt e emigracionit, përveç bashkimit familjar që duket se ka qenë arsye kryesore për emigracionin për 43 përqind të migrantëve femra të cilat janë përfshirë në vrojtim. Për kthimin, arsyt kryesore përfshijnë humbjen e punës në vendin e imigracionit, mallin për familjen dhe vendin, si edhe probleme që hasen nga familja në Shqipëri. Arsye të tjera për kthimin përfshijnë mundësi më të mira punësimi në Shqipëri, plane për investim ose probleme shëndetësore. Përsëri, nuk është vënë re dallim thelbësor gjinor në lidhje me arsyt e kthimit. Këto gjetje konfirmohen edhe nga analiza e të



dhënave të mbledhura nga Sportelet e Migracionit në periudhën korrik 2010- korrik 2012 si edhe nga gjetjet e studimeve të mëparshme që janë ndërmarrë nga IOM.

Shumica e emigrantëve (60.3 përqind) janë kthyer në vendbanimin e tyre të zakonshëm përpara migracionit. Megjithatë vrotimi zbulon që migracioni i kthimit është i lidhur edhe me migrimin e brendshëm të popullsisë. Tendenca e të kthyerve është që të vendosen në qarqe me zhvillim të lartë socio-ekonomik ku mund të realizojnë planet e tyre të jetës. Tirana është qarku më i preferuar, i ndjekur nga Vlora, Elbasani, Fieri dhe Korça (në rastin e të kthyerve nga Greqia) dhe Shkodra, Lezha, Durrësi dhe Dibra (për të kthyerit nga Italia).

Situata e punësimit të përhershëm për shumicën e të kthyerve nuk ka ndryshuar shumë pas kthimit të tyre krahasuar me atë përpara emigrimit (nga 11.7 përqind përpara migracionit në 11 përqind në kohën e vrotimit). Përkundrazi, situata e vetë-punësimit ka ndryshuar nga 7.4 përqind përpara migracionit në 21.6 përqind në kohën e vrotimit. Kjo tregon që të kthyerit kanë qenë të prirur që të investojnë njohuritë, aftësitë dhe kapitalin financiar të fituar jashtë vendit në veprimtari që gjenerojnë të ardhura. Rritja e punësimit në sektorin bujqësor nga 14.6 përqind në 30.7 përqind është vënë re pas migracionit. Kjo mund të shihet si një tregues i tendencës për investime në bujqësi. Në përgjithësi, shkalla e investimit në Shqipëri pas kthimit ka qenë vetëm 8 përqind. Këto investime kryesisht janë bërë për tregtinë me pakicë, hoteleri dhe restorante dhe bujqësi. Për shumicën e investimeve, të kthyerit janë mbështetur në kursimet e tyre (99 përqind), ndonjëherë në kredi bankare (15 përqind) dhe tek prindërit ose të afërmit (9 përqind).

Vrotimi ka parë edhe tendencën e të kthyerve për të qëndruar në vendin e origjinës ose për të ri-emigruar. Rezulton që financat janë tregues kyç i motivimit pas procesit vendimmarrës të migrantit. Përpara emigrimit jashtë vendit, situata financiare e migrantëve ka qenë ose jo e mirë ose shumë e keqe, por është përmirësuar ndjeshëm gjatë qëndrimit jashtë vendit. Megjithatë, me kthimin në Shqipëri, shumica e të kthyerve nuk shohin situatën e tyre financiare të ndryshuar krahasuar me situatën jashtë vendit (41.3 përqind), ndërsa 38.8 përqind e tyre e shohin situatën financiare të përkeqësuar, dhe vetëm për 20 përqind duket se situata është përmirësuar. Një përqindje e konsiderueshme (32.6 përqind) e të kthyerve kanë si synim të emigrojnë përsëri për shkak të vështirësive në sigurimin e të ardhurave të mjaftueshme për familjet e tyre.

**Ekzistenca e shërbimeve** është gjithashtu një faktor i rëndësishëm që ndikon në vendimin për të qëndruar në Shqipëri ose për t'iu kthyer mundësisë së ri-migracionit. Sipas vrotimit shumë pak të kthyer kanë marrë ndihmë pas kthimit të tyre në Shqipëri dhe kur kjo ka ndodhur, ata më së shumti u janë drejtuar ofruesve të shërbimeve private. Shumica e të kthyerve (60.3 përqind) ka raportuar që mungesa e shërbimeve të duhura dhe sistemi shëndetësor i papërshtatshëm (56.2 përqind) janë dy probleme të hasura pas kthimit në Shqipëri.

Sipas vrotimit shumica e të kthyerve nuk kanë dijeni për Sportelet e Migracionit në vend dhe shërbimet që ofrojnë këto struktura në mbështetje të ri-integrimit të të kthyerve. Ky konstatim tregon nevojën që Sportelet e Migracionit të afrohen më shumë me të kthyerit. Më së shumti, të kthyerit kanë marrë shërbime lidhur me punësimin nga Sportelet e Migracionit dhe referim në shërbimet e tjera.

Në bazë të gjetjeve të vrotimit, si edhe evidencës së mbledhur nga rishikimi i literaturës, raporti rekomandon: i) vazhdimin e mëtejshëm të punës kërkimore në fushën e migracionit të kthimit në Shqipëri për të mbledhur prova në lidhje me tendencën e tij dhe për të vlerësuar ndikimin e tij tek vetë të kthyerit, familjet e tyre dhe komunitetet ku ata vendosen; ii) eksplorimin e mëtejshëm të lëvizshmërisë së migrantëve me qëllim punësimi nga Shqipëria drejt vendeve fqinjë dhe brenda Shqipërisë, pas kthimit të tyre; iv) eksplorimin e mëtejshëm të ndikimit të kthimit në tregun e punës në Shqipëri, si edhe ndikimin e mundësisë së punësimit në vendimin për të qëndruar në Shqipëri ose për të migruar përsëri; v) përmirësimin e shërbimeve të ri-integrimit të ofruara për të kthyerit (mbështetje për fillimin e një biznesi, shërbime në lidhje me punësimin dhe investimin në sektorin bujqësor, etj).

Raporti është i strukturuar në 5 kapituj; i) kapitulli i parë e njeh lexuesin me objektivat e studimit dhe përkufizimet që përdoren; ii) kapitulli i dytë bën një rishikim të sfondit teorik të migracionit të kthimit dhe ri-integrimit si pjesë e ciklit të kthimit. Ai thekson rëndësinë e eksplorimit të rrugëve të ri-integrimit të suksesshëm si mënyrë për të siguruar maksimizimin e potencialit të migracionit të kthimit për zhvillim në të mirë të të kthyerit dhe komunitetit ku ai/ajo vendoset; iii) kapitulli i tretë bën një përshkrim të detajuar të metodologjisë së vrotimit përfshirë përdorimin e metodave sasore të kërkimit, kuadrin dhe njësitë e kampionimit, pyetësorin e përdorur si edhe metodat për interpretimin dhe analizimin e të dhënave; iv) kapitulli i katërt tregon gjetjet kryesore që rezultojnë nga vrotimi në terren; v) kapitulli i fundit paraqet shkurtimisht konkluzionet e përgjithshme të studimit dhe disa rekomandime specifike për aktorë të ndryshëm të përfshirë në fushën e migracionit.



**1**

**HYRJE**



## INFORMACION PARAPRAK PËR VROJTIMIN

Dy dekada pas migracionit masiv të shqiptarëve në vendet Europiane Perëndimore, flukset migratore nga Shqipëria janë ulur për shkak të stabilitetit në rritje dhe zhvillimit ekonomik në vend. Sipas Censurit të Popullsisë 2011, 4.9 përqind e popullsisë shqiptare, që korrespondon me 139.827 shtetas që kanë qëndruar jashtë vendit, janë kthyer pas vitit 2001 (INSTAT, 2012). Kriza financiare botërore në veçanti ka pakësuar mundësitë e migrantëve për të punuar në Greqi pas vitit 2010, një nga vendet kryesore të destinacionit për migrantët shqiptarë, duke çuar në kthimin e tyre në Shqipëri. Në përpjekje për të matur më mirë migracionin e kthimit në Shqipëri pas trazirave ekonomike të vitit 2009, Instituti i Statistikave (INSTAT) dhe Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) bashkuan përpjekjet për të ndërmarrë një vrotim kombëtar për të matur më mirë migracionin e kthimit në Shqipëri dhe për të ofruar rekomandime të vlefshme mbi orientimin e shërbimeve në ndihmë të ri-integrimit të të kthyerve. Vrotimi synon të hedhë dritë mbi faktorët e ndryshëm që i japin trajtë modeleve të ri-integrimit të të kthyerve në Shqipëri. Ai synon të theksojë heterogjenitetin që karakterizon kategoritë e të kthyerve duke analizuar nevojat e tyre përkatëse në Shqipëri.

Për shkak të vështirësive për të arritur një grup të synuar në një lëvizje të vazhdueshme, vrotimi u bazua në të dhënat e Censurit të Popullsisë dhe Banesave 2011, me qëllim krijimin e një kampioni përfaqësues për të gjithë vendin. Prandaj, gjetjet e vrotimit siç ilustrohen më poshtë në raport përfaqësojnë të gjithë popullsinë e të kthyerve në Shqipëri për periudhën 2009-2013.

## OBJEKTIVA TË VROJTIMIT

Objektivat specifike të vrotimit janë:

- Profilizimi i migracionit të kthimit në Shqipëri, faktorët shtytës dhe tërheqës, karakteristikat e migrantëve të kthyer;
- Mbledhja e informacionit për përvojat e migrantëve dhe perceptimet për ri-integrimin në Shqipëri;
- Formulimi i disa rekomandimeve për aktorë të ndryshëm në lidhje me studimin e mëtejshëm të migracionit të kthimit dhe ofrimin e shërbimeve që lehtësojnë ri-integrimin e të kthyerve.

## STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E RAPORTIT

Vrotimi synon të hedhë dritë mbi faktorë të ndryshëm që i japin trajtë modeleve të ri-integrimit të të kthyerve në Shqipëri. Për këtë arsye, raporti përdor një sërë përkufizimesh që trajtojnë analizën në kapitullin e rishikimit të literaturës dhe në veçanti analizimin e të dhënave të vrotimit në terren. Lista e plotë e përkufizimeve të përdorura gjendet në Aneksin 1, megjithatë disa përkufizime kryesore të përdorura janë:

### ◆ përkufizimi i **migracionit të kthimit**:

*Lëvizja e një personi që kthehet në vendin e tij/saj të origjinës ose vendbanimit të zakonshëm pasi kalon të paktën një vit në një vend tjetër. Ky kthim mund të jetë vullnetar ose jo. Migracioni i kthimit përfshin riatdhesimin vullnetar. Çdo person që kthehet në vendin e tij/saj të origjinës, gjatë pesë viteve të fundit, pasi ka qenë migrant ndërkombëtar (afat shkurtër apo afatgjatë) në një vend tjetër. Kthimi mund të jetë i përhershëm ose i përkohshëm. Ai mund të vendoset në mënyrë të pavarur nga migranti ose të detyrohet nga rrethanat e pafavorshme.<sup>1</sup>*

### ◆ përkufizimi i **të kthyerit**:

*Çdo person që kthehet në vendin e tij/saj të origjinës, pasi ka qenë migrant ndërkombëtar (minimalisht për një vit) në një vend tjetër. Kthimi mund të jetë i përhershëm ose i përkohshëm. Ai mund të vendoset në mënyrë të pavarur nga migranti ose të detyrohet nga rrethanat e papitura.*

### ◆ përkufizimi i **ri-integrimit**

*Ripërfshirje apo ritrupëzimi i një personi në një grup ose proces, p.sh. një migrant në shoqërinë e vendit të tij të origjinës ose të qëndrimit të zakonshëm.<sup>2</sup>*

<sup>(1)</sup> IOM:2011, Glosar për Migracionin, botimi i dytë, fq 86

<sup>(2)</sup> ibid







# 2

## GJETJE NGA STUDIMI I LITERATURËS



## VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I MIGRACIONIT TË KTHIMIT

Studimi i literaturës i paraqitur në këtë kapitull jep një përgjigje teorike sintetike dhe të bazuar në të dhëna për pyetjet e mëposhtme: a) pse kthehen migrantët dhe çfarë motivon dhe ndikon në procesin e kthimit; b) cilat janë sfidat e ri-integrimit dhe faktorët që ndikojnë në ri-integrimin e suksesshëm; dhe në përfundim c) cili është reagimi që vendi i origjinës mund të ketë për të lehtësuar ri-integrimin e migrantëve të kthyer?

Që prej vitit 1960, migracioni i kthimit ka qenë objekt i qasjeve të ndryshme nga disiplina dhe shkolla të ndryshme mendimi. Një sërë kërkimesh empirike në lidhje me këtë çështje janë përpjekur të shpjegojnë faktorët e shumëfishtë që trajtojnë modelet e kthimit dhe ri-integrimit të migrantëve në vendin e tyre të origjinës. Përkufizimet e migracionit të kthimit gjithashtu janë të ndryshme sipas qasjeve teorike. Disa studiues dhe praktikantë përkufizojnë kthimin në lidhje me kohën dhe hapësirën dhe prandaj bëjnë dallimin ndërmjet kthimit të përkohshëm dhe të përhershëm (Agunias, 2006). Të tjerë, si IOM (2011) bazojnë përkufizimin e tyre të migracionit të kthimit në formën e kthimit (vullnetar ose jo vullnetar) dhe kohën e kaluar jashtë vendit (të paktën një vit). Në dy dekadat e fundit, kthimi është përkufizuar ngushtësisht në leksikon aktual të agjencive qeveritare dhe ndër-qeveritare si “akti i largimit nga territori i vendit të destinacionit”. Në Bashkimin Europian (BE), për shembull, ky vizion i kthimit është paraqitur si një “pjesë e pandarë” e instrumenteve për të trajtuar migracionin e parregullt në përpjekje për të mbrojtur integritetin e sistemeve të imigracionit dhe azilit në shumicën e shteteve anëtare (Këshilli Europian, 2002; Komisioni Europian, 2005).

Arsyet e kthimit variojnë nga ngjarje politike apo ekonomike të shkallës makro në perspektiva individuale të migrantit. Russell King (2000) e portretizon migracionin e kthimit si një proces të filluar nga faktorë të ndryshëm shkakësorë dhe që çon në një larmi pasojash. Ai më tej shprehet që faktorët shkakësorë mund të jenë: a) ekonomikë (papunësia/përfundimi i kontratës, më shumë punë/ punë më të mira, dëshira për të investuar kursimet); b) socialë (armiqtë racorë/vështirësi në integrim, malli për familjen, dëshira për status më të lartë); c) familjare/cikli i jetës (dalja në pension, lidhjet prindërore, martesë, shkollimi i fëmijëve); ose politikë (përfundimi i politikës qeveritare për të dërguar dhe për të marrë). Në varësi të konteksteve të ndryshme, disa faktorë mund të jenë më me vend se të tjera.

## FAKTORË QË NDIKOJNË TEK RI-INTEGRIMI

Pavarësisht larmisë së përkufizimeve të përdorura, faktori i përbashkët në të gjitha qasjet teorike dhe përkufizimet e përdorura për migracionin e kthimit mbetet interesi i të gjithë të interesuarve për të maksimizuar potencialin e migracionit të kthimit në të mirë të migrantit, familjes së tij/saj dhe komunitetit të kthimit. Kjo perspektivë bëhet edhe më e dukshme kur analizohen teoritë e migracionit të kthimit si ajo neoklasike, teorisë së ekonomisë së re e të migracionit të punës, teoria strukturaliste, transnacionalizmi dhe teoria e rrjetit social. Këto teori dallojnë nga njëra-tjetra në thelb nga arsyet e të kthyerit, perspektiva e të kthyerit për kthimin dhe roli i vendit të origjinës në të ashtu-quajturin “kthim të suksesshëm”. Ky i fundit si koncept është përkufizuar shpesh nga studiuesit (p.sh Black et al., 2004) si kthim i qëndrueshëm. Sipas tyre, “është e dobishme të konsiderohen tre këndvështrime prej të cilave mund të konceptohet qëndrueshmëria. Së pari, kthimi mund të shihet si i qëndrueshëm në lidhje me situatën e çdo të kthyeri personalisht dhe në lidhje me shoqërinë në tërësi. Së dyti, “qëndrueshmëria” e individëve mund të konsiderohet nga këndvështrimi “subjektiv” i të kthyerve, si edhe sa i përket matjes objektive të situatës së tyre. Së treti, qëndrueshmëria mund të matet në lidhje me vendndodhjen fizike të vendit të dëshiruar nga migrantët pas kthimit, por edhe në lidhje me konsideratat socio-ekonomike dhe të sigurisë politike. Suksesi i ri-integrimit shpesh matet nëpërmjet kthimit të qëndrueshëm.

Nga ana tjetër, studiuesit dhe praktikantët në fushën e migracionit të kthimit bien dakord që ri-integrimi i suksesshëm ka dy dimensione të ndërlidhura: *dimensioni i parë* që lidhet me suksesin personal, që përfshin sigurinë sociale dhe ekonomike të migrantit si një individ (përfshirë familjarët) në komunitetin lokal të vendit të origjinës. *Dimensioni i dytë* lidhet me kontributin e kthimit në zhvillimin ekonomik dhe social të komunitetit të kthimit dhe të vendit të origjinës. Migracioni i kthimit mund të jetë stimul real për zhvillimin e komuniteteve lokale ku vendosen të kthyerit. Migrantët mund të investojnë kursimet e tyre për veprimtaritë produktive, të përdorin aftësitë e tyre dhe ekspertizën e fituar në migracion dhe kështu mund të gjenerojnë punësim për familjarët dhe komunitetin e tyre. Migrantët mund të japin një shtysë të re në zhvillimin e tregut të punës dhe avancim teknologjik në vendet e origjinës. Megjithatë, King R. tekta citon Ghosh (2000) thërret vëmendjen tonë në një dallim të dobishëm ndërmjet mirëqenies ekonomike të migrantit individ ose familjes që kthehet dhe kontributit agregat që migracioni i kthimit jep për vendin, rajonin dhe komunitetin e origjinës. Sipas tij, numri i të kthyerve, kohëzgjatja e mungesës në vend, destinacioni i kthimit, klasa shoqërore dhe natyra e trajnimit të fituar jashtë vendit, mënyra e organizimit të kthimit, mund të ndikojnë të gjitha negativisht tek ri-integrimi në vend.



Përkufizimi i IOM për ri-integrimin, bën thirrje për të vlerësuar ndikimin social, ekonomik dhe kulturor të ri-integrimit duke parë kushtet në vendin e origjinës. *Ri-integrimi kulturor* shihet si procesi i ri-integrimit të të kthyerve tek vlerat, mënyra e jetesës, gjuha, parimet morale dhe traditat e shoqërisë së vendit të origjinës dhe *ri-integrimi ekonomik*, si riperfshirje në sistemin ekonomik të vendit të origjinës, me synim përdorimin e ekspertizës së fituar në migracion për të promovuar zhvillimin ekonomik dhe social të vendit të origjinës. *Ri-integrimi social* përfshin zhvillimin e një rrjeti personal dhe nga ana tjetër zhvillimin e strukturave të shoqërisë civile si shoqatat, etj (IOM, 2011). Duke patur parasysh sa më sipër, “qasja me tre faza” për migracionin e kthimit e shtjelluar nga Jean-Pierre Cassarino (2008) përfaqëson një model gjithëpërfshirës konceptual për të analizuar migracionin e kthimit dhe ri-integrimin. Kjo qasje e sheh migracionin e kthimit si pjesë të ciklit migrator; të gjitha fazat e ciklit migrator ndikojnë në dëshirën dhe gatishmërinë e migrantit për t’u kthyer, rrjedhimisht në suksesin e ri-integrimit të tij/saj. Sipas Cassarinos,

*[... .. “ ky zgjerim gradual i spektrit të migracionit të kthimit nuk ka çuar vetëm në kompleksitetin në rritje të arsyeve të kthimit, por edhe në larminë e metodave të ri-integrimit dhe në modele të mobilizimit të burimeve të nevojshme për rivendosjen e tyre në vendin e tyre. Këto modele pa dyshim pasqyrojnë përvojat e migracionit të të kthyerve në vendin e tyre të mëparshëm të imigracionit. Ato trajtësohen gjithashtu nga kushte politike, institucionale, ekonomike dhe sociale pas kthimit në vend. Këto konsiderata janë të rëndësishme nëse duhet kuptuar si dhe pse modelet e ri-integrimit të të kthyerve ndryshojnë nga njëra-tjetra. Madje, ato janë të rëndësishme për të kuptuar parakushtet për të forcuar lidhjen ndërmjet migracionit të kthimit dhe zhvillimit... ]* Jean-Pierre Cassarino (2008)

“Qasja me tre faza” strukturohet përgjatë tre fazave kryesore migratore: Faza 1) situata përpara largimit nga vendi i origjinës; Faza 2) përvoja e migracionit në vendin kryesor të imigracionit; Faza 3) kthimi në vendin e origjinës- kushtet pas kthimit. Me fjalë të tjera, kjo qasje bën të mundur: i) kuptimin e shtrirjes së përvojës së migracionit, si edhe kontekstit social dhe institucional në vend, për të ndikuar në modelet e ri-integrimit; ii) analizimin pse dhe si kapitali human, social dhe financiar i të intervistuarit ka ndryshuar me kohën; iii) krahasimin në mënyrë diakronike të faktorëve të ndryshëm që kanë motivuar dhe trajtësuar fazat migratore.

Modeli i Cassarinos përfaqëson edhe qasjen teorike të përdorur në këtë studim e cila bën të mundur që të kuptohet më mirë përvoja e migracionit, faktorët që kanë motivuar dhe trajtësuar fazat migratore, konteksti social dhe institucional në vend dhe ndikimi i tyre në modelet e ri-integrimit. Ri-integrimi i të kthyerve konsiderohet pjesë e ciklit të kthimit edhe pse vetë kthimi mund të jetë i përkohshëm, në varësi të vendimit të migrantit për t’u vendosur apo jo në vendin e origjinës dhe kohëzgjatjes së kthimit. Gatishmëria për t’u kthyer ka të bëjë me pasjen e mundësisë dhe aftësisë për të mbledhur burimet e prekshme dhe të paprekshme që nevojiten për të garantuar kthimin në vend. Pra, gatishmëria për t’u kthyer është mundësi politikash për politik-bërësit si nga vendi pritës ashtu edhe nga vendi i origjinës për të reaguar në mënyrën e duhur ndaj fluksit migrator të kthimit.

## MIGRACIONI I KTHIMIT NË KONTEKSTIN SHQIPTAR

Migracioni i kthimit është shfaqur si pjesë e fenomenit të migracionit modern, megjithatë të dhëna të qëndrueshme për trendin e migracionit të kthimit përgjithësisht kanë munguar. Në vitin 2004, Qendra Universitare e Sussex për Kërkimin për Migracionin ka ndërmarrë projektin e parë kërkimor që synoi të përkufizojë, masë dhe ndikojë në kthimin e qëndrueshëm në Ballkanin Perëndimor. Projekti ofroi disa rekomandime të dobishme për mënyrën e përgatitjes së procesit të ri-integrimit për migrantët e kthimit në këto vende të cilat mund të shërbejnë si burim i dobishëm për qeveritë përkatëse që të krijojnë platforma për politika të suksesshme ri-integrimi dhe ndërhyrje të planifikuara. Megjithatë, projekti nuk mundi të shkojë deri në matjen e migracionit të kthimit në këto vende.

Në përpjekje për të eksploruar më mirë lidhjet ndërmjet sistemit të migracionit, shkollimit dhe trajnimit dhe tregjeve të punës në vitin 2007, Fondacioni Europian i Trajnimeve (ETF) ka ndërmarrë një studim pilot në Shqipëri. Studimi tregoi që migracioni do të vazhdojë të luajë rol në Shqipëri në periudhën afat-shkurtër dhe meshkujt do të jenë më të prirur (46.9%) për të migruar në krahasim me femrat (40.9%). Shumica e migrantëve të mundshëm do të shihnin gjithashtu migracionin si një proces që çon në mundësi më të mira pune me t’u kthyer në Shqipëri. Studimi tregoi edhe që shumë pak migrantët të kthyer (1.6%) kishin dijeni për programe mbështetëse të qeverisë të cilat kanë si synim lehtësimin e kthimit. Gjetjet e vrojtimit të ETF sugjeruan që migracioni i kthimit është një fitim i mundshëm që deri tani nuk është përdorur plotësisht në Shqipëri dhe rekomandojnë që të ofrohen programe të efektshme ri-integrimi për migrantët të kthyer të mundshëm, përfshirë pritjen më të mirë dhe këshillimin për mundësi investimi, mbështetje për biznesin dhe kredi për sipërmarrjen.

Në vitin 2008, studimi i IOM Tirana “*Identifikimi i zonave më të prekura nga emigracioni dhe migracioni i kthimit në Shqipëri: profili i migrantëve të kthyer*” paraqet profilin e parë të migrantëve të kthyer në Shqipëri. Nga studimi rezulton që migracioni i kthimit në Shqipëri ka shumë veçori dhe përfshin si dimensionin vullnetar ashtu edhe atë jo vullnetar,

prandaj edhe përvojat e kthimit konsiderohen së bashku me një vijueshmëri që varion nga pozitive në negative. Studimi tregon që 66 përqind e atyre që përballen me papunësinë në vendet e destinacionit shprehen se do të konsideronin kthimin e përhershëm, nëse do të kishte punësim të sigurt në Shqipëri. Kushte të tjera të rëndësishme për kthimin e përhershëm do të ishin arsyet familjare (23%) dhe kushte jetese të pranueshme (14%). Papunësia dhe mungesa e mbështetjes institucionale në vendet e destinacionit u identifikuan si përcaktuese të kthimit të përhershëm. Studimi u fokusua edhe në çështje të *vështirësive dhe shërbimeve të ri-integrimit*; 60% e pjesëmarrësve e përshkruan integrimin si të vështirë, ndërsa për 24% ndodhte e kundërta. Studimi gjithashtu u përpoq që të identifikonte masën e ndihmës së marrë përpara ose pas kthimit. Pjesa dërmuese prej 83% e kampionit u shpreh që nuk kishin marrë asnjë lloj ndihme pas kthimit. Gjithashtu, studimi vërejt i llojet e ndihmës së marrë dhe variacionet ndërmjet formave të kthimit (p.sh vullnetar, i rregullt, i detyruar, etj). Ai tregoi se format kryesore të ndihmës për të gjitha format e kthimit kanë qenë transportimi i sendeve përkatëse, mbështetja në përpjekje për të gjetur punë, lehtësimi i ri-integrimit social dhe trajnimi profesional. Në rastet kur kthimi ishte vullnetar dhe i ndihmuar nga organizata ndërkombëtare dhe jo qeveritare, burimi kryesor i mbështetjes ishte për ri-integrim, kryesisht ndihmë në fushën arsimore dhe të formimit profesional. Sipas vrojtimit, nga shumica e përgjigjeve (55%) rezultoi që duhet të ofrohen mundësi punësimi për të bërë të mundur procese graduale të kthimit dhe ri-integrimit. Stimujt financiar (25%) janë perceptuar si të rëndësishëm, po ashtu si edhe programe të trajnimit profesional (6%). Këto gjetje pasqyrojnë arsyet kryesore që çojnë tek migracioni në radhë të parë, të cilat janë të lidhura me punësimin dhe motivet ekonomike.

Burime të tjera të rëndësishme në lidhje me dimensionin e migracionit të kthimit në Shqipëri paraqiten në një studim të zhvilluar së fundmi nga Eda Gemi në vitin 2013 me titull *“Migracioni i parregullt shqiptar në Greqi: tipologji e re e krizës”*. Siç e sugjeron qartë ky titull, flukset e fundit të migracionit të kthimit në këtë studim janë parë nga këndvështrimi i parregullshmërisë dhe rasti studimor i zgjedhur ka qenë Greqia. Duke cituar burimet e Ministrisë së Brendshme Helene, Gemi vëren që rreth 130.000 deri në 140.000 punëtorë migrantë shqiptarë kanë humbur lejen për të qëndruar në Greqi për shkak të krizës financiare, sepse nuk kanë mundur që të sigurojnë numrin e kërkuar të vulave të sigurimeve shoqërore (të quajtura IKA). Megjithatë, ajo thekson që “është shumë e vështirë të vlerësohet nëse të gjithë ata që janë vendosur në Shqipëri, janë kthyer përsëri në Greqi apo kanë migruar në vende të tjera me ekonomi më të mira (ELIAMEP, 2013).

Censusi i popullsisë në 2011 dha një vështrim më të qartë të migracionit të kthimit në periudhën 2001-2011. Një botim i INSTAT-it për “Migracionin në Shqipëri” i vitit 2014, tregon që kthimet janë rritur çdo vit, sidomos pas vitit 2008 (INSTAT, 2011). Pjesa dërmuese e të kthyerve të regjistruar janë meshkuj (rreth 2/3 e numrit të përgjithshëm) dhe moshë mesatare është 30-34 vjeç. Duke pasur parasysh numrin e të kthyerve sipas vendeve, të dhënat e censurit tregojnë që rritja e kthimeve përgjithësisht ndodh për shkak të shqiptarëve që vijnë nga Greqia, të ndjekur më pas nga ata që vijnë nga Italia. Në një numër më të vogël, kthimet bëhen nga vende të tjera si MB, SHBA, Gjermani dhe Turqi. Sa i përket arsyeve të kthimit, dominojnë arsyet familjare dhe të punës, njësoj si për meshkujt ashtu edhe për femrat.

Pas analizimit të studimeve dhe vrojtimit specifik për migracionin e kthimit në Shqipëri gjatë viteve të fundit, mund të vërehet që një studim më sistematik për migracionin e kthimit, përfshirë të tre fazat e kthimit (Cassarino, 2004) nevojitet për të profilizuar më mirë migrantët e kthyer dhe për të trajtuar shërbimet përkatëse për kthim gradual dhe të qëndrueshëm. Gjithashtu, dinamika e migracionit të kthimit nga Greqia kërkon analizë të thellë për të kuptuar më mirë ndikimin e krizës në lëvizshmërinë e punëtorëve migrantë nga Shqipëria.

## RRUGËT E RI-INTEGRIMIT NË SHQIPËRI

Që në vitin 2010, Qeveria e Shqipërisë ka bërë përpjekje të vazhduara për të zhvilluar dhe zbatuar një kuadër politikash për migracionin e kthimit dhe ri-integrimit. Strategjia e Ri-integrimit për Shtetasit e Kthyer Shqiptar (2010-2015) dhe Plani i tij i Veprimit u miratua në vitin 2010. Qëllimi i përgjithshëm i strategjisë është të sigurojë kthimin e qëndrueshëm të migrantëve shqiptarë nëpërmjet mbështetjes në procesin e ri-integrimit në vend, pavarësisht formës së kthimit, vullnetar apo jo. Strategjia gjithashtu parashikon ofrimin e shërbimeve specifike për kategori të caktuara të pambrojtura të të kthyerve, në përputhje me dispozitat e politikave të tjera ekzistuese (si Strategjia e Anti-trafikimit), dispozitat ligjore (si ato për viktimat e trafikimit, fëmijët e pashoqëruar, popullin rom, migrantët me probleme ekonomike etj) ose projekte/ programe specifike të hartuara dhe të zbatuara me mbështetjen e donatorëve të ndryshëm (Qeveria Shqiptare 2010).

Elementi kryesor i mekanizmit të ri-integrimit janë Sportelet e Migracionit që ndodhen në 36 zyra punësimi vendore dhe rajonale në mbarë vendin, të cilat vlerësojnë nevojat e ri-integrimit të migrantëve të kthyer dhe i referojnë ata tek shërbimet publike ekzistuese, si shërbimi shëndetësor, arsimor, i punësimit dhe kështu me radhë. Krijimi i këtyre mekanizmave ilustron përpjekjet e vendit për të konsoliduar institucionet që ofrojnë shërbime dhe mbështetje sociale dhe për të rritur aksesin e popullsisë në këto shërbime publike. Megjithatë, është e vështirë të garantohet shtrirja e arritjes



së qëllimit të institucionalizimit të mbështetjes për ri-integrimin e të kthyerve. Në përpjekje për të profilizuar të kthyerit dhe për të vlerësuar nevojat e tyre, Grazhdani (2013) bën një analizë të Sporteleve të Migracionit bazuar në statistikat e mbledhura në periudhën korrik 2010 kur këto sportele filluan të funksionojnë deri në korrik 2012<sup>3</sup>. Profili i të kthyerit tregoi që shumica e kthimeve janë bërë nga Greqia (86 %). Shumica e të kthyerve janë kthyer me familjet e tyre, 74 përqind dhe 79.1 përqind e tyre kanë pasur si synim qëndrimin afatgjatë në Shqipëri. Arsyet kryesore të kthimit përfshijnë papunësinë në vendin e destinacionit (88%), të ndjekur nga mungesa e dokumentacionit dhe dëshira për të investuar në vend (SHKP, 2013). Gjithsej janë regjistruar 1752 të kthyer si punëkërkuar të papunë, krahasuar me 912 që u regjistruan në vitin 2011 dhe të paktën 15% e të kthyerve kanë përfituar ndihmë ekonomike. Në vitin 2012 shumica e migrantëve të kthyer ka pasur përvojë pune në sektorë si ndërtim, bujqësi, shërbime, punë shtëpiake, turizëm, shërbime mekanike dhe elektrike etj dhe synojnë që të gjejnë punë në këto sektorë ku e ndjejnë se kanë njohuri dhe aftësi të mjaftueshme.

Regjistrimi në Sportelet e Migracionit bëhet mbi baza vullnetare. Specialisti i Sportelit të Migracionit zhvillon një intervistë për të vlerësuar nevojat e të kthyerit, sidomos nevojat më urgjente për ta drejtuar të kthyerin në shërbimet publike që janë në dispozicion. Edhe pse pritshmëritë e të kthyerve janë që Sportelet e Migracionit të ofrojnë një gamë shërbimesh publike për të kthyerit, kjo nuk është e mundur për shkak të komponentëve të ndryshëm që përmban ri-integrimi dhe që kërkojnë ndërhyrje të ofruesve të ndryshëm të shërbimeve (shërbime punësimi, shërbime shëndetësore, shërbime arsimore etj). Gjithashtu është e rëndësishme të theksohet që sa i përket shërbimeve të punësimit, Sportelet e Migracionit nuk arrijnë të ndihmojnë të kthyerit në zonat rurale. Sipas statistikave kombëtare, të kthyerit në zonat rurale konsiderohen të vetë-punësuar nëse familja zotëron sipërfaqe toke. Kur ata konsiderohen të vetë-punësuar në bujqësi, nuk mund të kërkojnë përfitime papunësie ose ndihmë ekonomike ose shërbime të tjera ndërmjetësimi për punë, nëse nuk deklarohen se nuk jetojnë më në zona rurale. Si pjesë e shërbimeve të orientimit në karrierë, të kthyerit gjithashtu drejtohen në trajnime profesionale (16% e të kthyerve në vitin 2012). Një pjesë e mirë e të kthyerve marrin mbështetje për të patur akses në shërbime shëndetësore (32.29% gjatë 2012) dhe shpesh drejtohen tek Sportelet e Migracionit që të regjistrohen si punëkërkuar të papunë me qëllim që të sigurojnë akses falas në shërbimet shëndetësore. Shërbime të tjera referimi me ndikim më të dukshëm në komunitet dhe në zhvillimin e vendit janë orientimi për fillimin dhe rritjen e biznesit (3% e të kthyerve gjatë vitit 2012).

<sup>(3)</sup> Duhet theksuar që përpara 2010, Sportelet e Migracionit u krijuan me mbështetjen e IOM në disa Zyra Rajonale Punësimi që u përzgjedhën, megjithatë ato kishin funksione të kufizuara.



# 3

## **METODOLOGJIA E VROJTIMIT NË TERREN**





## PYETËSOR ME TRE FAZA

Vrojtimi është realizuar nëpërmjet një pyetësoi të strukturuar. Në përputhje me objektivat e vrojtitimit, përmbajtja e pyetësoi është e orientuar për të mbledhur të gjithë informacionin e nevojshëm për çështjet e mëposhtme:

- ◆ Kushtet socio-ekonomike dhe socio-demografike të të kthyerve përpara largimit nga Shqipëria, gjatë migracionit dhe pas kthimit;
- ◆ Arsyet për largimin nga vendi dhe për kthimin në Shqipëri;
- ◆ Përvojat e integritimit në vendin e fundit të destinacionit dhe ndikimi i tyre në vendimin për t'u kthyer në Shqipëri;
- ◆ Procesi i kthimit në Shqipëri dhe mundësia e qëndrimit; Lidhjet me vendin e fundit të imigracionit;
- ◆ Mbështetja për ri-integrim dhe përvoja e ri-integritimit të të kthyerve në Shqipëri.

Pyetësoi zbaton gjerësisht modelin e Cassarinos, që përmban qasjen me tre faza të migracionit, të zhvilluar dhe të zbatuar nga Qendra Robert Schuman<sup>4</sup>. Modeli është përshtatur për ta bërë sa më të efektshëm zbatimin e tij në terren, në Shqipëri, si edhe për të lehtësuar hedhjen dhe verifikimin e të dhënave elektronike. Pyetje shtesë janë prezantuar edhe nga INSTAT dhe IOM për të mbledhur informacion specifik në lidhje me procesin e ri-integritimit të të kthyerve në Shqipëri. Pyetësoi përbëhet nga pyetje të mbyllura si edhe pyetje të hapura, sidomos në lidhje me profesionet dhe fushën e veprimtarisë ekonomike. Alternativa "tjetër" është prezantuar për disa nga pyetjet që të merret informacion shtesë sipas nevojave.

Në disa pyetje janë dhënë disa zgjedhje, ndërsa struktura më e zakonshme është struktura dyshe (përgjigje Po/Jo). Ky konfigurim është zgjedhur për të lehtësuar përpunimin e të dhënave. Gjithashtu, kjo bën të mundur regjistrimin e duhur të disa çështjeve komplekse si përbërja familjare, kategorinë e punësimit dhe sektorët dhe llojet e investimeve. Në disa raste, të intervistuarit janë pyetur për të klasifikuar përgjigjet sipas radhës së përparësisë, sidomos në lidhje me arsyet e kthimit. Pyetje filtruese janë përdorur në pyetësoi për të theksuar larinë e përvojave migratore dhe modelet e shumëfishta të ri-integritimit. Është përdorur nomenklatura e Eurostat për kodet e vendeve dhe kodet e ISCO për profesionet janë thjeshtuar për qëllim të vrojtitimit.

Nisur nga madhësia relativisht e vogël e kampionit, saktësia është shumë e rëndësishme. Vlerësimet në disa nëngrupe janë relativisht të pasakta me koeficientë të mëdhenj variacioni. Nëse supozojmë që efekti i dizajnit të kampionit për përqindje të vogla është afër  $deff=1$  në llogaritjen e koeficientëve të variacionit, ne mund të përdorim formula për kampionimin e thjeshtë rastësor.

Të njëjtat konkluzione mund të përdoren për të llogaritur vlerësimet për popullsinë. Në publikimin e vlerësimeve, kriteret e mëposhtme për saktësinë janë marrë në konsideratë:

- Vlerësime me koeficient variacioni  $CV < 0.10$  publikohen pa kufizime.
- Vlerësime me  $0.10 < CV < 0.15$  shprehen në thonjëza teke
- Vlerësime me  $0.15 < CV < 0.30$  shprehen në thonjëza dyshe
- Vlerësime me saktësi më pak se  $CV < 0.30$  nuk publikohen

<sup>(4)</sup> Burimi: RDP, MIREM © EUI, <http://rsc.eui.eu/RDP/>



Pyetësori është strukturuar në tre faza kryesore të migracionit:

Faza 1	Faza 2	Faza 3
<b>Situata përpara largimit nga vendi i origjinës</b>	<b>Përvoja e migracionit në vendin kryesor të imigracionit</b>	<b>Kthimi në vendin e origjinës - kushtet pas kthimit</b>
Karakteristika demografike dhe sociale; Arsyet për largimin nga Shqipëria; Kushtet sociale dhe financiare përpara largimit nga Shqipëria; Përbërja familjare përpara largimit (nëse ka); Shkollimi dhe aftësitë përpara largimit; Situata e punësimit.	Përvoja e migracionit; Arsyet për të jetuar në vendin/vendet e imigracionit; Kohëzgjatja e përvojës së jetuar jashtë vendit; Kushtet sociale dhe financiare në vendin/vendet e imigracionit; Përbërja familjare (nëse ka); Shkollimi dhe aftësitë e fituara jashtë vendit; Situata e punësimit dhe financiare; Marrëdhënia me institucionet vendore jashtë vendit dhe me shoqërinë pritëse; Lidhjet/kontaktet me Shqipërinë.	Udhëtimi i kthimit; Arsyet dhe faktorët që nxisin kthimin; Kohëzgjatja e pritshme e kthimit; Kushtet sociale dhe ekonomike pas kthimit; Përbërja familjare pas kthimit; Shkollimi dhe aftësitë e fituara pas kthimit; Statusi i punësimit dhe financiar pas kthimit; Marrëdhëniet me institucionet vendore dhe shoqërinë në Shqipëri pas kthimit; Lidhje me vendin/vendet e mëparshëm të imigracionit; Projekt pas kthimit dhe qëndrueshmëria e kthimit.

Siç e thekson Cassarino (2012), këto tre faza mundësojnë identifikimin e faktorëve të brendshëm në përvojën migratore të të kthyerve, si edhe të faktorëve të jashtëm, ndërsa kthimi shihet si një proces i ndryshueshëm, qoftë ky i përhershëm ose i përkohshëm. Prandaj qasja bën të mundur:

- kuptimin e shtrirjes së përvojës së migracionit, si edhe kontekstit social dhe institucional në vend, për të ndikuar në modelet e ri-integrimit;
- analizimin pse dhe si kapitali human, social dhe financiar i të intervistuarit ka ndryshuar me kohën;
- krahasimin në mënyrë diakronike të faktorëve të ndryshëm që kanë motivuar dhe trajtësuar fazat migratore.

## PËRGATITJA E VROJTIMIT

Mbledhja e të dhënave u krye nga 16 shtatori- 14 tetor 2013 duke përdorur kampionin përfaqësues në shkallë kombëtare prej 2000 individësh. Vrojtimi u bazua në metodën e intervistimit ballë për ballë dhe është kryer nëpërmjet teknologjisë CAPI (intervistimi personal me ndihmën e kompjuterit). Përdorimi i CAPI-t redukton ndjeshëm kohën ndërmjet mbledhjes së të dhënave dhe analizimit të tyre, sepse kodimi manual i përgjigjeve të regjistruara me laps dhe letër nuk është më i nevojshëm dhe të dhënat vleftësohen në kohën që mblidhen. Faza pilot ishte e nevojshme për të përmirësuar administrimin e pyetësorit me qëllim që të minimizoheshin gabimet logjike dhe fizike të cilat mund të përmbante programi. Programi standard për mbledhjen e të dhënave u zhvillua në CSProX dhe të dhënat u përpunuan duke përdorur SPSS 17. Pas përfundimit të të gjitha hapave të përpunimit të të dhënave, rezultatet e vrojtimit u tabuluan me anë të paketës SPSS 17. Tabulatet më pas u kontrolluan më detaje për konsistencë të të dhënave, tituj, inpute, koncepte, si edhe shifra.

## PLANI I KAMPIONIMIT DHE NJËSITË E KAMPIONIMIT

### Përcaktimi i kampionit

Studimi përmbante një vrojtim të familjeve të popullsisë, në një periudhë të caktuar, të kryer në nivel kombëtar në secilën nga 12 qarqet e Shqipërisë. Kampioni i shtresëzuar u përdor për të përzgjedhur individët e kampionit. Njësitë primare të kampionimit (NJPK) të përzgjedhura në fazën e parë janë zonat e Censurit (ZC), të cilat janë zona të vogla operationale të përcaktuara në harta për mbledhjen e të dhënave për Censurin e 2011. Për të kontrolluar gabimet e mbulimit, të cilat e bëjnë kampionin më pak përfaqësues, plani i kampionimit duhet të ketë cilësi optimale gjatë të gjitha fazave të përzgjedhjes. Në fazën e parë, ZC duhet të mbulojë të gjitha zonat e banuara nga popullsia në studim, pa heqje ose duplikime. Kufijtë e ZC duhet të përcaktohen qartë dhe të jenë lehtësisht të identifikueshme në terren. Software SAS u përdor në këtë fazë për të përzgjedhur sistematikisht kampionin e ZE-ve me probabilitet proporcional me madhësinë (PPS) brenda çdo qaraku. Faza e dytë e përzgjedhjes ishte lista e njësive ekonomike familjare në ZC-të e përzgjedhura. Lista e njësive ekonomike familjare të numëruara në Censurin e 2011 për çdo ZC u përdor si kampionim me probabilitet të njëjtë. Faza e tretë e përzgjedhjes ishte përzgjedhja e personave në njësitë ekonomike familjare të përzgjedhura paraprakisht. Avantazhet e kësaj procedure përzgjedhjeje me dy faza janë:

1. Procedura e përzgjedhjes është e lehtë për tu zbatuar dhe redukton gabimet e mundshme të mos-kampionimit në procesin e përzgjedhjes.
2. Është e lehtë përcaktimi i individëve të përzgjedhur, duke reduktuar gabimet e mos-kampionimit dhe mungesën e përgjigjeve.
3. Intervistuesit intervistojnë vetëm personat në njësitë ekonomike familjare të përzgjedhura paraprakisht. Nuk lejohet zëvendësimi i njësive ekonomike familjare, duke mos lejuar kështu anshmërinë në vrojtim.

Në zhvillimin e kriterëve të përzgjedhjes së kampionit, vëmendje e veçantë ju kushtua përcaktimit të popullsisë së studimit dhe karakteristikave të saj. Bazuar në kriteret e paracaktuara, një individ u konsiderua si i kualifikuar për t'u përfshirë në vrojtim nëse ishte:

4. Një shtetas shqiptar që ka migruar jashtë vendit dhe është kthyer në Shqipëri, vullnetarisht ose jo;
5. 18 vjeç e lart.

Qëllimi ishte gjenerimi i një kampioni të njësive ekonomike familjare që do të mundësonte nxjerrjen e vlerësimeve të besueshme statistikore për natyrën dhe shtrirjen e migracionit të kthimit në Shqipëri dhe nevojat e ri-integrimit të të kthyerve në nivel kombëtar dhe që do të lejonte për krahasimin urban/rural.

### Madhësia e kampionit

Madhësia e kampionit për një vrojtim të veçantë përcaktohet nga saktësia e kërkuar për vlerësimet e vrojtimit për çdo fushë, si edhe nga burimi dhe kufizimet operationale. Saktësia e rezultateve të vrojtimit varet nga gabimi i kampionimit, që mund të matet nëpërmjet vlerësimit të variacionit dhe gabimi i moskampionimit që vjen nga të gjitha burimet e tjera, si gabime në përgjigje dhe matje të tjera, gabime në kodim dhe hedhjen e të dhënave. Është e rëndësishme të theksohet që INSTAT pranon se madhësia e kampionit të një vrojtimi të caktuar përcaktohet nga saktësia e kërkuar për vlerësime të nivelit kombëtar si edhe ndikohet nga çështje logjistike që lidhen me organizimin dhe madhësinë e ekipeve dhe ngarkesa në punë për administrimin e vrojtimit dhe mbledhjen e të dhënave. Duke pasur parasysh të gjithë këto faktorë, llogaritjet sugjerojnë që një kampion me madhësi 2000 individë do të jepte fuqi të mjaftueshme për të plotësuar objektivat e studimit. Kur përdoret kampionimi me shumë faza, efekti i dizajnit kryesisht mat ndikimin e nivelit të grupimit tek efica e kampionimit. Efekti i dizajnit varet nga numri i individëve kampion të përzgjedhur në çdo shtesë. Madhësia e kampionit për një qark të caktuar, urban dhe rural, është caktuar në proporcion me numrin e migrantëve në çdo qark.

Tabela 1 tregon shpërndarjen e ZC-ve të kampionit dhe individët sipas qarqeve, urban, rural. Madhësia totale e kampionit në nivel kombëtar është 250 ZC.



**Tabela 1.** Shpërndarja e Kampionit ZE dhe Individëve sipas Qarkut dhe zonës urbane/rurale

Qarku	Kampioni ZC			Kampioni Individët		
	Urban	Rural	Gjithsej	Urban	Rural	Gjithsej
Berat	6	8	14	48	64	112
Dibër	2	7	9	16	56	72
Durrës	15	5	20	120	40	160
Elbasan	10	16	26	80	128	208
Fier	12	22	34	96	176	272
Gjirokastrë	3	5	8	24	40	64
Korçë	10	13	23	80	104	184
Kukës	0	4	4	0	32	32
Lezhë	6	6	12	48	48	96
Shkodër	6	9	15	48	72	120
Tiranë	40	17	57	320	136	456
Vlorë	16	12	28	128	96	224
<b>Gjithsej</b>	<b>126</b>	<b>124</b>	<b>250</b>	<b>1008</b>	<b>992</b>	<b>2000</b>

## VLERËSIMI DHE ANALIZIMI I TË DHËNAVE

Një tërësi tabelash u përdorën nga të gjithë partnerët për të vlerësuar të dhënat në terren duke ju referuar një sërë variableve të varura dhe të pavarura. Këto tabela mundësuan analizën krahasuese të temave të mëposhtme:

- ◆ Arsyet dhe faktorët që çojnë ose përcaktojnë largimin jashtë vendit dhe kushtet pas kthimit;
- ◆ Lloji dhe kohëzgjatja e përvojës së migracionit;
- ◆ Ndikimi i përvojës së migracionit në modelet e ri-integrimit profesional të të kthyerve në vendin e tyre të origjinës dhe në mirëqenien e familjeve të tyre;
- ◆ Projektet e të kthyerve përpara dhe pas kthimit;
- ◆ Aftësitë e fituara jashtë vendit dhe në vendin e origjinës;
- ◆ Burimet financiare të të kthyerve dhe modelet e tyre të ri-integrimit në vend;
- ◆ Lidhjet e të kthyerve me vendin/vendet e mëparshëm të imigracionit;
- ◆ Ndihma që mund të kenë marrë të intervistuarit pas kthimit në vendin e origjinës;
- ◆ Llojet e investimeve nga të intervistuarit në vendin/vendet e mëparshme të imigracionit dhe në vendin e tyre të origjinës;
- ◆ Perceptimi i të kthyerve për mjedisin e tyre institucional.

Variablat e shumta që përmban pyetësi mundësojnë një analizë të detajuar të modeleve të ri-integrimit. Janë konsideruar dy kategori të ndryshme:

- ◆ Migrantë që kanë vendosur të kthehen me nismën e tyre në vendin e tyre të origjinës dhe ata që janë të detyruar për t'u kthyer. Kapitujt e ardhshëm strukturohen mbi gjashtë fushat tematike të mëposhtme:
  - Karakteristikat socio-demografike të të kthyerve të intervistuar;
  - Situata socio-profesionale dhe aftësitë;
  - Burimet: Kapitali social dhe financiar;
  - Përvoja migratore jashtë vendit;
  - Kthimi dhe modelet e ri-integrimit;
  - Kushtet pas kthimit dhe perspektivat.



# 4

## GJETJET NGA VROJTIMI NË TERREN



## KARAKTERISTIKAT SOCIO-DEMOGRAFIKE

### Shpërndarja e të kthyerve sipas moshës dhe gjinisë


Nga vrojtimi rezulton që në Shqipëri në periudhën 2009-2013 janë kthyer gjithsej 133.544 shtetas shqiptarë të moshës 18 vjeç e lart.

**Tabela 2.** Të kthyerit shqiptarë sipas grupmoshës

Grupmosha	Gjithsej
18-24	19.987
25-29	26.428
30-34	20.970
35-39	14.247
40-44	12.090
45-49	9.817
50-54	9.792
55-59	7.524
60-64	4.342
65+	8.347
<b>Gjithsej</b>	<b>133.544</b>

Shifra më poshtë tregon një raport me peshë të të kthyerve që vijnë në Shqipëri në fazat e hershme të ciklit të jetës së tyre, kur janë relativisht të rinj. Moshë më e zakonshme për t'u kthyer në Shqipëri është ndërmjet 25 dhe 29 vjeç. Përqindja e të kthyerve në moshë pensioni nuk është e lartë (rreth 6%), edhe pse prezumohet që shqiptarët punojnë jashtë vendit deri kur arrijnë moshën e pensionit dhe pastaj kthehen në Shqipëri. Meqenëse shumë punëtorë migrantë emigrojnë në moshën 20 dhe 30 vjeçare, mund të jetë shumë herët që të konstatohet migracioni i kthimit për dalje në pension- ata që kanë qenë 20 dhe 30 vjeç në vitin 1989 vetëm tani po i afrohen moshës së pensionit.

**Figura 1.** Të kthyerit shqiptarë sipas grupmoshës dhe gjinisë, (%)





Në lidhje me gjininë, duket se ekziston një dallim i ndjeshëm mes raporteve të të kthyerve, ku meshkujt janë të mbipërfaqësuar në krahasim me femrat, 73.7% dhe 26.3%, përkatësisht. Modeli i shpërndarjes së moshës mes meshkujve dhe femrave, megjithatë, çuditërisht është i njëjtë.

Meqenëse përgjithësisht meshkujt kanë më shumë mundësi që të lëvizin për arsye punësimi (INSTAT, 2014) nuk është për t'u habitur që raporti i të kthyerve të grupmoshës 25-45 të jetë më i lartë për meshkujt. Përkundrazi, shpërndarja për femrat është disi lineare meqë femrat mund të lëvizin më shumë për arsye familjare. Pavarësisht arsyeve të ndryshme për migracion, kulmi i moshës së femrave është njësoj ashtu si dhe për meshkujt (INSTAT, 2014).

## GJENDJA CIVILE E TË KTHYERVE

Të dhënat për gjendjen civile tregojnë që mbi 30% e të gjithë të kthyerve kanë mbajtur gjendjen e tyre civile "beqar/e" gjatë migracionit dhe pas kthimit në Shqipëri. Ndryshe nga kjo, përqindja e migrantëve që janë martuar jashtë vendit është më e lartë sesa e atyre që janë martuar pas kthimit në Shqipëri (11.8% kundrejt 6.6%).

**Tabela 3.** Ndryshimi i gjendjes civile të të kthyerve shqiptarë gjatë itinerarit të migracionit, (%)

Gjendja civile	
Beqar/e	30,0
Martuar përpara emigrimit	47,5
Martuar gjatë emigrimit	11,8
Martuar pas emigrimit	6,6
Status tjetër	4,1
Gjithsej	100,0

## LLOJI I KTHIMIT DHE VENDI I FUNDIT I DESTINACIONIT

Më shumë se 94% e të kthyerve vendosën me vullnetin e tyre që të kthehen ndërsa më pak se 6% e tyre kanë qenë të detyruar. Në analizimin e moshës, duket se të kthyerit, që janë kthyer të detyruar nga rrethanat për t'u larguar nga vendi pritës, kanë qenë më të rinj sesa ata që kanë vendosur të largohen me dëshirën e tyre.

**Tabela 4.** Shqiptarët e kthyer sipas llojit të kthimit dhe moshës mesatare, (%)

	Përqindje	Mosha mesatare
Kthim vullnetar	94,3	38,6
Kthim i detyruar nga rrethanat	5,7	34,2
Gjithsej	100	38,3


Greçia ka qenë vendi i destinacionit të fundit për shumicën e të kthyerve (70.8%) e ndjekur nga Italia, Mbretëria e Bashkuar dhe Gjermania, ndërsa kthimet nga vende të tjera kanë qenë në nivele më të ulëta dhe janë grupuar nën kategorinë "Tjetër" me 2.4 përqind.



**Tabela 5.** Të kthyerit sipas vendit të fundit të emigracionit, (%)

	Përqindje	Vite mesatare të qëndrimit
Greqi	70,8	7,0
Itali	23,7	4,3
Angli	1,6	4,1
Gjermani	1,1	6,0
SHBA	0,6	4,2
Tjetër	2,2	4,1
Gjithsej	100,0	6,2

Kthimet kanë qenë në rritje që prej vitit 2011. Nëse kjo gjetje analizohet së bashku me gjetjet për vendin e kthimit, është e dukshme që rritja e numrit ka ardhur si pasojë e kthimeve nga Greqia që kanë ndodhur më së shumti për shkak të krizës financiare në këtë vend dhe ndikimit të saj negativ në tregun e punës.

**Figura 2.** Të kthyerit sipas vitit të kthimit, (%)

## PËRBËRJA FAMILJARE PËRPARA LARGIMIT JASHTË VENDIT, NË VENDIN PRITËS DHE PAS KTHIMIT

Të dhënat në lidhje me përbërjen familjare tregojnë që shumica e shqiptarëve (42.8%) përpara së të migronin jetonin në “familje të mëdha” (me prindër dhe/ose vëllezër dhe motra dhe të tjerë); kjo lidhet me faktin që më shumë se gjysma e të kthyerve shqiptarë deklarojnë që gjendja e tyre civile përpara se të migronin ishte “beqar/e”. Këto lloj familje kanë qenë të shumta përpara migracionit ndërsa pësuan një ulje në vendin e fundit të emigracionit dhe akoma më shumë pas kthimit 40.6% dhe 32% përkatësisht.

Nga ana tjetër, familjet me “një bërthamë familjare” (domethënë familje që përmbajnë një çift me apo pa fëmijë, mama/ baba i vetmuar me fëmijë), numëronin më shumë se 31.4% të të gjitha familjeve përpara migracionit. Përqindja u rrit në 37% në vendin pritës dhe pas kthimit arriti 45.9%. Këto rezultate çojnë në konkluzionin që pas kthimit ka ndodhur një ndryshim nga “familje e madhe” në një “familje me një bërthamë”.



**Tabela 6.** Përbërja familjare e të kthyerve shqiptarë pasi largohen nga vendi, në vendin e fundit të emigracionit dhe pas kthimit, (%)

Përbërja familjare	Përpara emigrimit	Në vendin e fundit të emigrimit	Pas kthimit
Vetëm	2,3	15,2	3,6
Me bashkëshortin/bashkëshorten	10,3	7,6	11,0
Me fëmijët	1,4	2,7	1,3
Me bashkëshortin/bashkëshorten dhe fëmijët	19,8	26,9	33,7
Me bashkëshortin/bashkëshorten, fëmijët dhe të tjerë	7,2	5,1	13,4
Me prindërit	15,9	2,6	12,0
Me vëllain dhe motrën	0,7	5,2	0,3
Me prindërit, motrat dhe vëllezërit	27,0	3,8	13,3
Me prindërit, motrën, vëllezërit dhe të tjerë	6,6	0,6	4,3
Me familjarë ose miq të tjerë	1,2	26,0	0,8
Përbërje tjetër	7,6	4,4	6,5

## SITUATA E STREHIMIT

Në lidhje me strehimin, të dhënat e mbledhura tregojnë që përpara largimit nga Shqipëria, 82% e migrantëve jetonin në shtëpi private dhe rreth 15% jetonin në apartament. Vetëm një përqindje e vogël e familjeve të këtij vrojtimi jetonin në institucion, 0.6%. Situata ndryshoi shumë gjatë migracionit; shumica e migrantëve shqiptarë jashtë vendit jetonin në apartamente dhe jo në shtëpi private, 62 % dhe 36 % përkatësisht.

**Tabela 7.** Situata e strehimit të të kthyerve shqiptarë përpara emigrimit dhe në vendin e fundit të emigracionit, (%)

Situata e strehimit	Përpara emigrimit	Vendi i fundit i emigrimit
Shtëpi private	82,3	36,2
Apartament	14,9	62,4
Institucion	0,6	0,8
Tjetër	2,2	0,7
Gjithsej	100	100

Statusi i akomodimit në vendin e fundit të emigracionit që paraqitet në tabelën 7 tregon një rritje të numrit të pronarëve. Përqindja e pronarëve shkoi në rritje nga 4% në kohën e mbërritjes së tyre në vendin e fundit të emigracionit në mbi 6% vetëm përpara kthimit në Shqipëri.

Përkundrazi, përqindja e migrantëve që merrnin shtëpi me qira u ul disi përpara largimit nga vendi i fundit i emigracionit krahasuar me situatën e mbërritjes së tyre, 86% dhe 87% përkatësisht.


**Tabela 8.** Statusi i akomodimit në vendin e fundit të emigracionit, me mbërritjen e tyre dhe vetëm përpara kthimit të tyre, (%)

Lloji i akomodimit	Me të mbërritur	Përpara kthimit
Pronar	4,0	6,1
Qiramarrës	86,9	85,9
Strehim falas	8,7	7,4
Tjetër	0,4	0,6
Gjithsej	100,0	100,0

## QARQET E QËNDRIMIT TË TË KTHYERVE PËRPARA MIGRIMIT DHE PAS KTHIMIT


Siç shihet në Figurën 3, shumica e të kthyerve janë vendosur në vendin e tyre të lindjes ose në vendin e banimit të tyre të zakonshëm. Kjo gjetje mund të shpjegohet me praninë e familjarëve të tjerë, njohjen e vendit dhe komunitetit dhe lehtësinë e ri-përshtatjes.

**Figura 3.** Të kthyerit sipas vendit të kthimit, (%)



Numri më i madh i të kthyerve janë vendosur në Tiranë, megjithatë jo të gjitha qarqet preken njësoj nga migracioni i kthimit. Siç shihet në Figurën 4, Tirana, Fieri, Vlora dhe Elbasani janë qarqet e origjinës së të kthyerve (qarqet e qëndrimit të të kthyerve përpara se të migronin) me përqindjen më të lartë, mbi 10%, ndërsa në lidhje me qarqet e destinacionit (qarqet e qëndrimit pas kthimit), Tirana, Durrësi dhe Vlora janë ato që kanë përjetuar një rritje sa i përket përqindjes së të kthyerve të vendosur në këto qarqe.

**Figura 4.** Qarqet e qëndrimit përpara emigrimit dhe pas kthimit, (%)






Ky krahasim ndërmjet vendit të banimit të zakonshëm dhe qëndrimit pas kthimit tregon që migracioni i kthimit është i lidhur me rivendosje të brendshme të popullsisë. Tendenca e të kthyerve është që të vendosen në qarqet me zhvillim të lartë social-ekonomik ku mund të realizojnë planet e tyre të jetës.

Një konstatim interesant është ndikimi i migracionit të kthimit në qarqe ku janë vendosur të kthyerit. Raporti i migracionit krahasuar me popullatën e banorëve duket se është më i lartë në qarkun e Tiranës, Gjirokastrës, Dibrës dhe Lezhës. Ky konstatim mund të përdoret si tregues për ofrimin e mbështetjes për ri-integrim në këto qarqe nga institucione shtetërore për të trajtuar më mirë sfidat që dalin nga migracioni i kthimit.


**Figura 5.** Përqindja e migracionit të kthimit sipas qarkut<sup>5</sup>, (%)



## TË KTHYERIT SIPAS NUMRIT TË VITEVE QË KANË JETUAR JASHTË VENDIT DHE LËVIZSHMËRISË SË TYRE

Në lidhje me lëvizshmërinë e migrantëve, vrojtimi tregon që 64% e të gjithë të pyeturve janë larguar nga Shqipëria vetëm një herë që të jetojnë jashtë vendit, ndërsa 10% kanë emigruar të paktën 3 herë. Siç shihet në Figurën 6, shumica e migrantëve që kanë emigruar një herë kanë jetuar jashtë vendit për 5 vjet ose më shumë (39%). Përkundrazi, për ata që kanë migruar tre ose më shumë herë, kohëzgjatja e qëndrimit varion ndërmjet një dhe dy viteve, 4% dhe 3% e të kthyerve, përkatësisht. Pjesa dërrmuese e të kthyerve shqiptarë (45%) kanë pasur një përvojë relativisht të gjatë migracioni me kohëzgjatje qëndrimi jashtë vendit prej 5 ose më shumë vitesh, gjë kjo që është qartazi e lidhur me ato raste që kanë pasur më pak lëvizshmëri. Ata që kanë lëvizur më shumë (3+ herë) kanë pasur më shumë mundësi që të kenë një përvojë relativisht të shkurtër migracioni.

<sup>(5)</sup> Llogaritur bazuar në popullsinë banuese 2013 për çdo qark, vlerësim i INSTAT

**Figura 6.** Të kthyerit sipas numrit të viteve që kanë jetuar jashtë vendit dhe lëvizshmërisë së tyre


Lëvizshmëria	Numri i viteve të jetuara jashtë vendit				
	1	2	3	4	5+
1	8%	8%	5%	4%	39%
2	6%	9%	3%	2%	5%
3+	4%	3%	2%	1%	1%

## VENDET KRYESORE TË DESTINACIONIT PËR EMIGRANTËT SHQIPTARË DHE KOHËZGJATJA MESATARE E QËNDRIMIT JASHTË VENDIT

Sif shihet në Figurën 7, rritja e migracionit të kthimit në vite është shkaktuar nga rritja e numrit të kthimeve nga Greqia. Përqindja e shqiptarëve që kthehen nga Italia gjithashtu ka pësuar rritje, megjithatë jo aq të ndjeshme sa kthimet nga Greqia.



**Figura 7.** Vendet e emigracionit dhe kohëzgjatja mesatare e qëndrimit, (%)



Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit (vitet)	Vite
Greqi	7,0
Gjermani	6,0
Itali	4,3
SHBA	4,2
MB	4,1
Tjetër	4,1

Norma mesatare e kohëzgjatjes së qëndrimit jashtë vendit ka qenë mbi 6 vjet, ndërsa kohëzgjatja më e madhe e qëndrimit jashtë vendit ka qenë mes të kthyerve nga Greqia, (7 vjet).


## ARSYET KRYESORE TË EMIGRACIONIT

Tre faktorët kryesorë tërheqës të emigracionit kanë qenë: Papunësia (71.8%) e ndjekur nga mundësi më të mira pune 67.7% dhe mundësi për të ardhura më të larta me 64.7%, përkatësisht. Edhe pse jo në përqindje të lartë, bashkimi familjar është arsye migracioni për 16.3% të të intervistuarve dhe për 43.8% të femrave. Pasiguria e përgjithshme në vend është perceptuar gjithashtu nga 8.8% e të pyeturve si një faktor shtytës për emigracionin.

**Tabela 9.** Arsyet e emigracionit, (më shumë se një alternativë\*)

Arsyet e emigracionit	Përqindje
Papunësia	71,8
Mundësi më të mira pune	67,7
Mundësi për të ardhura më të mira jashtë vendit	64,7
Ofertë punësimi jashtë vendit	16,5
Bashkim familjar	16,3
Pasiguria e përgjithshme në Shqipëri	8,8
Mungesa e strehimit	5,5
Bashkimi me miqtë	4,4
Tjetër	3,8
Arsye shëndetësore	3,2
Arsye (probleme) sociale	2,3

\* mund të jepet më shumë se një përgjigje për pyetjet përkatëse

**Figura 8.** Arsyet e emigracionit sipas gjinisë, (%)

## ZHVILLIMI I SITUATËS SË PUNËSIMIT GJATË CIKLIT TË MIGRACIONIT

Shumica e migrantëve, 58.8% përpara se të migronin ishin të papunë; 11.7% kishin punë të përhershme, 7.4% ishin të vetë punësuar dhe 11.8% ishin studentë. Një përqindje e vogël prej 3.7% ishin në pension në kohën që kishin vendosur të migronin.

Situata e punësimit ka ndryshuar me të mbërritur në vendin e destinacionit. Përqindja e papunësisë u ul nga 58.8% në 27%, një ulje e ndjeshme. 55 përqind e të pyeturve paguheshin me rrogë me vendin e destinacionit, që ishte pothuajse pesë herë më e lartë krahasuar me situatën përpara migracionit. Kjo gjetje përforcon faktin që arsyeja kryesore për migracionin ka qenë përmirësimi i situatës ekonomike të migrantit nëpërmjet punësimit. Përkundrazi, numri i atyre që ishin të vetë punësuar u ul nga 7.4% në 3.5% përkatësisht. E njëjta tendencë u ndje edhe për studentët, me një rënie nga 11.8% përpara migracionit në 6% me të mbërritur në vendin e destinacionit.

Një gjetje interesante është ndryshimi i situatës së punësimit përpara kthimit në Shqipëri krahasuar me atë me të mbërritur në vendin e destinacionit. Përqindja e migrantëve në punësim të përhershëm u ul nga 55% me të mbërritur në vendin e destinacionit në 44.6% në momentin përpara kthimit në Shqipëri. Gjithashtu përqindja e migrantëve të papunë u rrit nga 26.6 përqind në 40.2% vetëm përpara se të largoheshin nga vendi pritës. Kjo gjetje mund të shpjegojë pjesërisht arsyen e kthimit në Shqipëri, rritja e papunësisë.

Pas kthimit në Shqipëri, situata e punësimit të përhershëm ra ndjeshëm nga 44.6% në 7.6% për të patur një rritje të vogël me 2.8% në kohën e vrojtimit. Po kështu, përqindja e të papunëve u rrit nga 40.2% në 60.3% dhe u ul në kohën e vrojtimit në nivelin 49.6%. Kjo rënie e papunësisë i kushtohet faktit që përqindja e vetëpunësimit në kohën e kthimit u rrit në nivelin 15.1% dhe në kohën e vrojtimit arriti 21.6%.


Në përpjekje për të bërë një krahasim të përgjithshëm të situatës profesionale dhe aftësive të migrantëve përpara migracionit dhe pas kthimit, mund të vihet re që situata e punësimit të përhershëm nuk ka ndryshuar shumë nga 11.7% përpara migracionit dhe 11% në kohën e vrojtimit. Përkundrazi, situata e vetë-punësimit ka ndryshuar nga 7.4 përqind përpara migracionit në 21.6 përqind në kohën e vrojtimit. Kjo tregon që të kthyerit kanë qenë të prirur që të investojnë njohuritë, aftësitë dhe kapitalin financiar të fituar jashtë vendit në veprimtari që gjenerojnë të ardhura. Papunësia gjithashtu është ulur edhe pse jo në nivele shumë të ndjeshme (nga 58.8% në 49.6%). Përgjithësisht, rritja e statusit të daljes në pension vërehet nga 3.7% në 8.1%. Kjo shpjegon pjesërisht arsyet e kthimit, sepse të kthyerit dëshirojnë që të kalojnë vitet e pleqërisë në vendin e tyre të origjinës. Përqindja e studentëve është ulur gjithashtu nga 11.8% në 1.8%. Kjo pasqyron një ulje normale sepse ata që përfundojnë studimet bëhen pjesë e forcës së punës.



Tabela 10. Zhvillimi i situatës së punësimit gjatë ciklit të emigrimit, (%)

Arsyet e emigracionit	Statusi i punësimit përpara emigrimit	Statusi i punësimit me të mbërritur në vendin e destinacionit	Statusi i punësimit përpara kthimit në Shqipëri	Statusi i punësimit fillestar pas kthimit	Statusi i punësimit aktual
<b>Punësim i përhershëm</b>	11,7	54,9	44,6	7,6	11
<b>Vetë-punësim</b>	7,5	3,5	2,5	15,2	21,6
<b>Papunësuar</b>	58,8	26,6	40,2	60,3	49,6
<b>Pensionist</b>	3,7	3,6	4,4	7,6	8,2
<b>Shtëpiake</b>	6	5	4,7	6,9	7,2
<b>Student</b>	11,8	6	3,2	1,8	1,8
<b>Tjetër</b>	0,5	0,4	0,4	0,6	0,6
<b>Gjithsej</b>	100	100	100	100	100

Figura 9. Ecuria e statusit të punësimit, (%)



Ndikimi i emigracionit dhe migracionit të kthimit në statusin e punësimit ka qenë i ndryshëm mes meshkujve dhe femrave.

Shumica e migrantëve, si meshkuj ashtu edhe femra, kanë qenë të papunë përpara se të migronin, por përqindja e papunësisë mes meshkujve ka qenë më e lartë krahasuar me femrat, 66.3% dhe 38% përkatësisht; ky boshllëk i konsiderueshëm mes meshkujve dhe femrave lidhet edhe me faktin që përqindja më e lartë e grave ka deklaruar që kanë qenë shtëpiake (21.5%) përpara se të migronin.

Situata e punësimit ka ndryshuar me të mbërritur në vendin e destinacionit si për meshkujt ashtu edhe për femrat. Përqindja e papunësisë është ulur për të dy, por me më shumë se gjysma për meshkujt krahasuar me situatën përpara migracionit. 61 përqind e meshkujve dhe 37 përqind e femrave ishin të punësuar në vendin e destinacionit, një përmirësim i ndjeshëm krahasuar me situatën përpara migracionit.

Përpara kthimit në Shqipëri, përqindja e migrantëve në punësim të përhershëm është ulur për të dy, por është më e dukshme tek meshkujt. Pas kthimit në Shqipëri, situata e punësimit të përhershëm ka rënë ndjeshëm për të dy me 6.5 përqind për femrat dhe 8% për meshkujt, ndërsa një përmirësim i lehtë vërehet në kohën e vrojtimit.



Figura 10. Ecuria e statusit të punësimit, femra, (%)




Figura 11. Ecuria e statusit të punësimit, meshkuj, (%)






Tabela 11 kombinon statusin e punësimit të të kthyerve në dy momente në kohë: Në vendin e fundit të emigracionit dhe në Shqipëri pas kthimit, të shpërndara sipas periudhës së gjetjes së punës dhe kërkimit të punës. Mes të kthyerve të punësuar, pjesa dërrmuese ka gjetur punë në më pak se tre muaj në të dyja rastet, në vendin e fundit të emigracionit dhe në vendin e origjinës, 64.2% dhe 57.9% përkatësisht. Në lidhje me të kthyerit e papunë, ata më shumë kanë pasur mundësi që të kërkonin vend punë jashtë vendit (64.9%) sesa në vendin e origjinës (47.9%).

**Tabela 11.** Të kthyerit sipas statusit të punësimit dhe periudhës së kërkimit të punës, (%)

		Në vendin e fundit të emigracionit	Në vendin e origjinës
I/e punësuar	Përpara largimit/kthimit	9,4	12,6
	Më pak se tre muaj pas emigrimit/kthimit	64,2	57,9
	Më shumë se tre muaj pas emigrimit/kthimit	26,4	29,5
	Gjithsej	100	100
Papunësuar	Po	64,9	47,9
	Jo	35,1	52,1
	Gjithsej	100	100

## PUNËSIMI SIPAS SEKTORIT GJATË MIGRACIONIT DHE PAS KTHIMIT

Nëse këto gjetje interpretohen së bashku me ato të shpërndarjes së punësimit sipas sektorit, siç paraqitet më poshtë, atëherë bëhet e dukshme që keqësimi i kushteve të punësimit në vendet kryesore të destinacionit, Greqi dhe Itali, ka pasur ndikim në rritjen e numrit të kthimeve në Shqipëri.

Disa gjetje interesante mund të nxirren nga analizi i punësimit sipas sektorëve në vendin e destinacionit dhe në Shqipëri pas kthimit. Në sektorin e bujqësisë vërehet një rritje nga 14.6% në 30.7% e punësimit pas migracionit dhe kjo mund të jetë tregues që të kthyerit po investojnë kursimet e tyre për zhvillimin e veprimtarive bujqësore në komunitetin e vendit të tyre të origjinës, duke pasur parasysh që shumica e migrantëve dhe të kthyerve vijnë nga zonat rurale. Punësimi i tyre kryesisht në sektorin e ndërtimit jashtë vendit (44.3%) mund të shpjegohet nga oferta e vendeve të punës në këtë sektor si edhe kërkesa për punëtorë jo të kualifikuar. Me kthimin në Shqipëri, punësimi në sektorin e ndërtimit ulet në nivelin 22.6%.

Punësimi në sektorin e turizmit është i vetmi sektor ku punësimi jashtë vendit dhe në Shqipëri mbetet në nivele të qëndrueshme, 12% dhe 11.3% përkatësisht. Tregtia me pakicë përfshin 10.6% të të kthyerve që janë punësuar në kohën e vrojtimit; për më tepër, ky sektor i industrisë ka treguar një rritje të madhe krahasuar me situatën në vendin e fundit të emigracionit, ku vlera e tij shënoi 2.9%.

**Tabela 12.** Punësimi sipas sektorëve të industrisë, (%)

Sektorët e industrisë	Vendi i fundit i emigrimit	Vendi i Origjinës - Pas kthimit
Bujqësi, gjueti dhe veprimtari të tjera shërbimi	14.6	30.7
Ndërtim	44.3	22.6
Shitje, mirëmbajtje dhe riparim i automjeteve dhe motorëve; shitje me pakicë e karburantit	1.8	2.6
Tregti me pakicë, përveç automjeteve dhe motorëve; riparim i sendeve personale dhe shtëpiake	2.9	10.6
Hoteleri dhe restorante	12.0	11.3
Transport tokësor; transport nëpërmjet tubacioneve	3.0	4.8
Veprimtari të tjera biznesi	2.2	6.1
Sektorë të tjerë të industrisë	19.0	6.6
E pavlefshme	0.2	4.6
Gjithsej	100.0	100.0

## NIVELI ARSIMOR

Pothuajse gjysma e të kthyerve (49.1%) kishin përfunduar arsimin e mesëm përpara se të largoheshin jashtë vendit; (37.0%) kishin përfunduar arsimin e lartë; 4.9% e të kthyerve kishin përfunduar arsimin fillor dhe vetëm 1.6% u përgjigjën që nuk kishin përfunduar asnjë nivel arsimor. Vetëm 3% e të kthyerve kishin përfunduar studime universitare dhe/ose pasuniversitare përpara se të migronin.

Një trend në rritje në përqindjen e atyre që kishin marrë një diplomë universitare/master ose doktoraturën në vendin e fundit të emigracionit (5.4%). Analiza e këtij konstatimi duhet të konsiderojë që rritja mund t'i kushtohet përfundimit të studimeve universitare nga të pyeturit që janë përgjigjur se në kohën e migracionit ata kanë qenë studentë. Është vënë re rritja e përqindjes së atyre që kanë studiuar në universitet/master në vendin pritës (5.1%) krahasuar me situatën përpara migracionit (2.9%). Vrojtimi gjithashtu tregon që migrantët që kanë studiuar në nivel arsimor të mesëm ose të lartë në vendin e destinacionit kanë vijuar me arsimim të mëtejshëm, universitar ose master. Një numër i vogël i të kthyerve ka kryer studime pas universitare jashtë vendit, me një përqindje më të lartë krahasuar me atë përpara së të migronin.

**Tabela 13.** Niveli arsimor i migrantëve përpara largimit dhe gjatë migracionit, (%)

	Përpara emigracionit	Në vendin e fundit të emigrimit
<b>Pa arsim</b>	1.6	0.9
<b>Arsim fillor</b>	4.9	3.8
<b>Arsim i mesëm</b>	49.1	47.2
<b>Arsim i lartë</b>	37.0	36.2
<b>Arsim profesional</b>	4.3	6.2
<b>Studime universitare/master</b>	2.9	5.1
<b>Studime pas universitare (PhD, tjetër)</b>	0.1	0.3
<b>Tjetër</b>	0.1	0.3
<b>Gjithsej</b>	100	100

## FORMIM PROFESIONAL

Të dhënat e vrojtimit tregojnë që të kthyerit kanë pasur shumë pak akses në formimin profesional në vendin kryesor të emigracionit (7.1%). Duhet theksuar që, pas kthimit, përqindja e migrantëve që i është drejtuar formimit profesional është ulur deri në nivele të pandjeshme (0.7%).

**Tabela 14.** Formimi profesional i të kthyerve, (%)

Formim profesional		
	Në vendin e fundit të emigrimit	Pas kthimit
<b>Po</b>	7.1	0.7
<b>Jo</b>	92.9	99.3
<b>Gjithsej</b>	100.0	100.0




## BURIMET E TË KTHYERVE: KAPITALI SOCIAL DHE FINANCIAR

### Situata financiare përpara largimit jashtë vendit, në vendin e fundit të emigracionit dhe në momentin e kthimit


Financat janë tregues kyç i arsyeve pas vendimit për migracion. Përpara migracionit jashtë vendit, 15.6% e kampionit ka pasur një situatë të mirë ose shumë të mirë financiare, ndërsa pjesa dërmuese e të kthyerve (72%) deklaroi që situata e tyre financiare ka qenë ose jo e mirë ose shumë e keqe.

**Figura 12.** Situata financiare e të kthyerve përpara largimit jashtë vendit, (%)




Situata financiare është përmirësuar ndjeshëm në vendin e destinacionit me 83% të të pyeturve të cilët shprehën që kanë pasur ose një situatë financiare të mirë ose shumë të mirë kur kanë jetuar në vendin e fundit të emigracionit. Megjithatë, duhet vënë në dukje që për pothuajse 17% të të kthyerve situata financiare në vendin e fundit të destinacionit ka mbetur e pandryshuar ose madje është keqësuar.

**Figura 13.** Situata financiare e të kthyerve në Shqipëri në vendin e fundit të emigracionit, (%)




Situata financiare e të kthyerve krahasuar me atë jashtë vendit në kohën e vrojtimit ka ndryshuar ndjeshëm. Shumica e të kthyerve shohin situatën e tyre financiare të pandryshuar (41.3%). 38.8% e tyre kanë situatë financiare më të rënduar pas kthimit, ndërsa vetëm për 20% situata financiare është përmirësuar.

**Figura 14.** Situata financiare e të kthyerve pas kthimit krahasuar me atë jashtë vendit, (%)

### Shpeshtia e remitancave


Gjatë vitit të tyre të fundit të qëndrimit jashtë vendit, pothuajse një e treta e të kthyerve ka deklaruar që nuk ka dërguar para për familjarët, ndërsa pothuajse i njëjti numër janë ata që kanë dërguar para në mënyrë sporadike për familjarët e tyre. Të kthyerit që kanë dërguar para një herë në muaj dhe një herë çdo tre muaj kanë qenë 10.4% dhe 11.9% përkatësisht.

**Figura 15.** Shpeshtia e remitancave për familjarët gjatë vitit përpara kthimit, (%)

Mes të kthyerve që kanë dërguar para për familjarët e tyre, 4.5% kanë dërguar më shumë se 1000 euro dhe 24.5% më pak se 200 euro në vit. Shuma më e shpeshtë e parave të dërguara ka qenë 200-500 euro dhe kjo shumë është dërguar nga 53.2% e të kthyerve.



**Figura 16.** Shuma e parave të dërguara në vendin e origjinës një vit përpara kthimit, (%)



Siç e tregojnë të dhënat e vrojtimit, migracioni shqiptar është migracioni i ndërmarrë më së shumti për arsye ekonomike. Kryesisht, të ardhurat e tyre përdoren për të plotësuar nevojat e përditshme të vetë migrantëve dhe familjeve të tyre, që jetojnë me ata ose që kanë qëndruar në Shqipëri. Një pjesë e këtyre të ardhurave ruhet dhe investohet për t'u përgatitur për ri-integrim në vendin e origjinës.

**Tabela 15.** Përdorimi i remitancave, (më shumë se një alternativë)

Përdorimi i remitancave	
Për të plotësuar nevojat e familjes	97.9
Për shkollimin e fëmijëve	22.7
Për të ndërtuar/blerë shtëpi	29.3
Për të investuar në një projekt ekonomik	5.4
Për të blerë tokë/fermë	4.3
Për të modernizuar pajisje bujqësore	2.1
Tjetër	1.8

Siç shihet në Tabelën 15, mbi 97% e të pyeturve dërgojnë para për të plotësuar nevojat e familjes, 22.7% për të paguar shkollimin e fëmijëve, 29.3% për të ndërtuar ose blerë shtëpi, ndërsa rreth 10% e të kthyerve kanë dërguar para për investime: projekt ekonomik ose blerje prone/ferme. Rreth 2% e të kthyerve kanë dërguar para për të modernizuar pajisje bujqësore. Siç mund të pritet, një përqindje shumë e vogël e të kthyerve (1.8%) nuk ka dërguar para gjatë përvojës së migracionit.

## Investime

Pas kthimit të tyre në Shqipëri, pjesa dërrmuese e të kthyerve nuk ka ndërmarrë ndonjë investim, 92% kundrejt 8% që kanë investuar për të realizuar të paktën një projekt.

**Figura 17.** Projekte investimi të realizuara nga të kthyerit në Shqipëri, (%)




Tabela 16 shpjegon arsyet pse të kthyerit nuk kanë investuar në vendin e tyre. Tre arsye janë më të qarta:

1. Kapital i pamjaftueshëm, që kufizon disponueshmërinë e burimeve financiare të nevojshme për të filluar një biznes;
2. Mungesa e ndonjë planifikimi paraprak për të bërë ndonjë investim në Shqipëri;
3. Mungesa e përvojës dhe trajnimit për investimin;

Mes arsyeve të përmendura, të dhënat tregojnë që kufizimet administrative dhe institucionale si edhe tregu i pamjaftueshëm janë arsye që nuk kanë lehtësuar investimet.


**Tabela 16.** Arsye për të mos bërë asnjë investim, (më shumë se një alternativë)

Arsye për të mos investuar	
Kapital i pamjaftueshëm	81.2
Mos-planifikim	36.6
Mungesa e përvojës dhe trajnimit	33.4
Treg i pamjaftueshëm	29.7
Kufizime administrative dhe institucionale	27.6
Mungesë dëshire	16.9
Probleme shëndetësore ose familjare	14.8
Tjetër	1.3

Burimi kryesor i mbështetjes financiare për projekte janë kursimet personale. Rreth 99% e investimeve të të kthyerve kanë si burim kryesor financiar kursimet personale. Megjithatë, është përdorur edhe kombinim i burimeve, kursime personale dhe kredi 15%, ose hua nga prindërit e tyre 9%.



**Figura 18.** Burimet kryesore të mbështetjes financiare për projekte investimi (më shumë se një alternativë)



Mes atyre që kanë investuar në vendin e tyre, 61.5% kanë hasur probleme gjatë investimit. Mes vështirësive të hasura, 52% e të kthyerve që kanë investuar në vendin e tyre kanë përmendur konkurrencën si vështirësi kryesore, të ndjekur nga kapitali i pamjaftueshëm (46%), mungesa e përvojës (40.0%), kufizimet administrative dhe sfidën menaxheriale që kanë qenë vështirësi për 39% të të kthyerve.

**Tabela 17.** Vështirësitë e hasura nga të kthyerit që kanë investuar në vendin e tyre, (më shumë se një alternativë)

Vështirësitë e hasura nga të kthyerit që kanë investuar në vendin e tyre	
Konkurrenca	52.0
Kapital i pamjaftueshëm	46.1
Mungesa e përvojës	40.0
Kufizim administrativ	39.3
Sfidë menaxhuese	39.1

## PËRVOJA E MIGRACIONIT PËRPARA KTHIMIT

### Marrëdhëniet në vendin e fundit të emigracionit

Në lidhje me marrëdhëniet në vendin e fundit të emigracionit, kontakte sporadike është përgjigja më e shpeshtë. Megjithatë, kontakti i shpeshtë me telefon, letra dhe postë elektronike (të paktën një herë në javë dhe disa herë në muaj) është përgjigja më e zakonshme. Në përfundim, të kthyerit që nuk kanë asnjë marrëdhënie me vendin e tyre të fundit të emigracionit janë më shumë se 1/10 e kampionit.


**Tabela 18.** Shpeshtia e kontakteve me familjarët gjatë vitit të fundit të qëndrimit jashtë vendit, (%)

Kontakt (telefon, letra, postë elektronike) me familjarët në Shqipëri	
Të paktën një herë në javë	48.1
Disa herë në muaj	26.2
Një herë në muaj	5.2
Disa herë në vit	4.5
Në mënyrë sporadike	14.1
Asnjëherë	1.9
Gjithsej	100.0



Gjatë qëndrimit të tyre jashtë vendit, pjesa dërrmuese e migrantëve shqiptarë nuk ka pasur kontakte me autoritetet shqiptare diplomatike ose konsullore. 17 përqind kanë pasur kontakte dhe arsyeja kryesore e këtyre kontakteve kanë qenë çështjet administrative.

**Figura 19.** Kontakti me autoritetet shqiptare diplomatike ose konsullore gjatë qëndrimit jashtë vendit dhe arsyet, (%)



Arsyet e kontaktimit të autoriteteve diplomatike ose konsullore*	
Arsye administrative	98.8
Për më shumë informacion për Shqipërinë	12.2
Për festa kombëtare	6.0
Tjetër	1.5

\* më shumë se një përgjigje mund të jepet për pyetjen përkatëse

### Kontaktet me familjarët që qëndrojnë në vendin e origjinës dhe vizitat në Shqipëri

Shumica e migrantëve shqiptarë gjatë vitit të fundit të qëndrimit jashtë vendit, kanë udhëtuar për në vendin e tyre në raste kryesisht sporadike dhe për arsye familjare. Udhëtimi për punë nuk ka qenë i shpeshtë, ndërsa udhëtimet për festa kanë ndodhur më së shumti një herë në vit ose në mënyrë sporadike. Arsyet administrative për udhëtim nuk duket se kanë pasur shumë rëndësi për të kthyerit.

**Tabela 19.** Shpeshtia e udhëtimit për në vendin e origjinës gjatë vitit të fundit të qëndrimit jashtë vendit, sipas arsyeve, (%)


	Dy ose më shumë herë në vit	Një herë në vit	Në mënyrë sporadike
Familjare	14.9	27.1	37.4
Punë	2.5	1.1	2.6
Festa (fetare)	9.2	12.7	26.7
Pushime	9.9	17.4	23.9
Arsye administrative	3.7	2.6	5.8

Figura 20 tregon me detaje shpeshtinë e udhëtimit në vendin e origjinës gjatë vitit të fundit të qëndrimit në vendin e



destinacionit. Tregon gjithashtu sa të kthyer nuk kanë udhëtuar asnjëherë për në vendin e tyre të origjinës gjatë vitit të fundit të qëndrimit në vendin e destinacionit, shifër kjo që duket se është tepër e lartë (33.8% nga totali). Udhëtimet dy ose më shumë herë në vit janë relativisht të pakta krahasuar me mundësitë e tjera (11.8% nga totali).


**Figura 20.** Shpeshtia e udhëtimit në vendin e origjinës gjatë vitit të fundit të qëndrimit jashtë vendit, (%)



### Arsyet kryesore të kthimit

42.5% e migrantëve shqiptarë janë kthyer në Shqipëri së bashku me familjarët e tjerë. 77% e tyre janë shoqëruar nga bashkëshorti/bashkëshortja, ndërsa 19% dhe 35% janë ndjekur nga fëmijët e rritur dhe të mitur përkatësisht.

**Figura 21.** Migrantët shqiptarë të kthyer së bashku me familjarët e tjerë, (%)



Të kthyerit e kthyer së bashku me*:	
Bashkëshortin/en	77.8
Fëmijët e rritur	18.7
Fëmijët e mitur	35.4
Vëllezërit/motrat	13.0
Prindërit	14.2
Anëtarët e tjerë të familjes	3.9

\* më shumë se një përgjigje mund të jepet për pyetjen përkatëse


Tabela 20 tregon arsyet kryesore të kthimit për ata të kthyer që kanë vendosur të kthehen vullnetarisht. Meqë arsyet mund të jenë më shumë se një, të pyeturve u jepet mundësia të zgjedhin mes disa alternativave. Përgjigja më e shpeshtë lidhet me krizën ekonomike dhe financiare që ka shkaktuar humbjen e punës në vendin e emigracionit për 63.2% të të kthyerve. Në përgjithësi, arsyet “problem” mbizotërojnë ndaj arsyeve “mundësi”. Vetëm 10.2% e të kthyerve janë kthyer me plane për investim në Shqipëri dhe 13.2% kanë shpresuar për mundësi më të mira pune. 5.4% kishin ngritur tashmë një biznes dhe ishin kthyer për ta menaxhuar. Një fakt interesant është që arsyet jo ekonomike si “Malli për vendin dhe traditat” kapnin një përqindje të ndjeshme prej 25.9% të përgjigjeve.

**Tabela 20.** Arsyet e kthimit për ata që vendosin vullnetarisht, (më shumë se një alternativë)

Arsyet e kthimit	
Humbja e punës në vendin e imigracionit	63.2
Malli për vendin dhe traditat	25.9
Probleme familjare në Shqipëri	24.6
Përfundimi i kontratës së punës në vendin e imigracionit	16.5
Mundësi më të mira pune në Shqipëri	13.2
Plane investimi në Shqipëri	10.2
Probleme shëndetësore	9.0
Pamundësia e përtëritjes së lejes	7.6
Probleme familjare në vendin e emigracionit	5.5
Menaxhimi i biznesit në Shqipëri	5.4
Probleme integrimi në vendin e imigracionit	5.1
Dalja në pension	4.5
Përfundimi i studimeve në vendin e imigracionit	3.9
Klima socio-kulturore e pafavorshme në vendin e imigracionit	3.0
Tjetër	5.7

Grafiku më poshtë tregon dallimet gjinore mes arsyeve të kthimit, një dallim që nuk është domethënës për shumicën e arsyeve të kthimit, përveç rastit të punësimit i cili është më tepër një arsye kthimi për meshkujt.

**Figura 22.** Arsyet e kthimit sipas gjinisë, (%)





## KTHIMI NË SHQIPËRI DHE MODELET E RI-INTEGRIMIT

### Perceptimi i të kthyerve për përvojën jashtë vendit

Përgjithësisht, të kthyerit e perceptojnë përvojën e tyre jashtë vendit si një avantazh. Megjithatë, meshkujt e perceptojnë më shumë si të tillë (78.5%) krahasuar me femrat (vetëm 69.7%).

**Tabela 21.** Perceptimi i të kthyerve për përvojën jashtë vendit sipas gjinisë, (%)

	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Avantazh	78.5	69.7	76.2
Disavantazh	0.5	1.5	0.8
E parëndësishme	11.3	21.6	14.0
Nuk e di	9.7	7.2	9.0
Gjithsej	100.0	100.0	100.0

Përvoja jashtë është perceptuar ndryshe edhe nga grupmosha të ndryshme. Sa më të rinj të kthyerit aq më shumë ajo konsiderohet avantazh. Kjo tendencë nuk është e tillë për ata që konsiderojnë si disavantazh përvojat migratore: kategoritë më të mëdha të të kthyerve të pakënaqur janë në grupmoshën 18-29 dhe 40-49. Nga ana tjetër, të kthyerit pa një opinion të qartë në lidhje me këtë çështje janë përsëri kategoria e më të rinjve, 18-29 vjeç.

**Tabela 22.** Perceptimi i të kthyerve për përvojën jashtë vendit sipas grupmoshës, (%)

	Avantazh	Disavantazh	E parëndësishme	Nuk e di	Gjithsej
18-29	34.0	34.1	33.7	42.8	34.8
30-39	27.7	13.0	21.4	24.0	26.4
40-49	18.1	36.9	12.1	6.9	16.4
50-64	15.5	3.7	18.3	20.3	16.2
65+	4.7	12.2	14.5	6.0	6.3
Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

## KUSHTET DHE PERSPEKTIVA PAS KTHIMIT

### Kohëzgjatja e pritshme e qëndrimit në vendin e origjinës në kohën e kthimit

Shumica e të kthyerve (39.6%) synojnë që të qëndrojnë në Shqipëri përgjithmonë krahasuar me ata që duan të qëndrojnë përkohësisht (27%). Përqindja e atyre që janë kthyer të detyruar nga rrethanat për të qëndruar përgjithmonë (49%) është më e lartë krahasuar me përqindjen e të kthyerve vullnetarë (39%). Ky fakt mund të shpjegohet me dështimin e përvojës migratore që ndikon në numrin e madh të kthimeve të detyruara nga rrethanat krahasuar me kthimet e vendosura nga të kthyerit. Megjithatë, duhet përmendur që të kthyerit që nuk e dinë me saktësi synimin e tyre për të qëndruar janë pothuajse 1/3 e totalit, si për rastet e kthimit vullnetar ashtu edhe për atë të detyruar nga rrethanat.

**Tabela 23.** Të kthyerit sipas synimit për të qëndruar në Shqipëri, (%)

	Kthim vullnetar	Kthim i detyruar	Gjithsej
Të përhershëm	39.1	48.5	39.6
Të përkohshëm	28.0	19.8	27.6
Nuk e di	32.9	31.7	32.8
Gjithsej	100.0	100.0	100.0

### Vështirësitë e hasura nga të kthyerit

Vështirësia më e madhe që hasin të kthyerit me t'u kthyer janë të ardhurat e pamjaftueshme. Edhe një herë arsyet ekonomike mbizotërojnë ndaj atyre sociale, administrative apo politike. Megjithatë, 60.3% e të intervistuarve i vënë fajin mungesës së shërbimeve të duhura dhe sistemit shëndetësor të papërshtatshëm. Kështu këto perceptime lidhen me kërkesën në rritje për përmirësimin e mirëqenies në Shqipëri, si një pjesë e pandarë e cilësisë së jetës, që merr parasysh jo vetëm PBB, por edhe treguesit socio-kulturorë. Në përfundim, vetëm 32.1% e të pyeturve e konsiderojnë vendin të paqëndrueshëm.

**Tabela 24.** Problemet e hasura pas kthimit në Shqipëri, (më shumë se një alternativë)

Problemet që hasen	
Të ardhura të pamjaftueshme	72.1
Mungesa e shërbimeve të duhura	60.3
Sistem shëndetësor i pamjaftueshëm	56.2
Burokraci	47.9
Paqëndrueshmëri në vend	32.1
Vështirësi për ri-integrimin socio-ekonomik	15.0

### Shërbime ri-integrimi

Shërbimet e ri-integrimit përbëjnë një element thelbësor të përvojës së të kthyerve pas kthimit. Shumica e tyre mendojnë se këto shërbime duhet të përmirësohen. Një përqindje e qëndrueshme e të intervistuarve nuk ka dijeni (25.3%) ose nuk di se ekzistojnë masat lehtësuese (18.5%).

**Tabela 25.** Perceptimi i të kthyerve për masat e marra për të lehtësuar kthimin në Shqipëri, (%)

Masat që duhet të merren	
Duhet të përmirësohen	41.2
Nuk kam njohuri	25.3
Nuk ekzistojnë	18.5
Janë të duhura	15.0
Gjithsej	100.0



Siç mund të kuptohet nga Tabela 26 dhe 27 të kthyerit kanë marrë më shumë shërbime nga ofrues privatë sesa nga ofrues shtetërorë, për t'u ndjekur nga ofrues të tjerë shërbimesh. Shërbimi më i zakonshëm që është marrë është mbështetja shëndetësore, e ndjekur nga mbështetja për të gjetur një vend pune. Shërbimi më pak i përfituar është mbështetja për formim profesional. Boshllëku i dukshëm ndërmjet kësaj të fundit dhe gjetjes së një vendi pune është tregues i qartë për marrëdhënien e paplotë të aftësive profesionale dhe ofertës për punë në tregun e punës në Shqipëri.

**Tabela 26.** Të kthyerit që kanë marrë mbështetje (më shumë se një alternativë)

Mbështetja e marrë nga të kthyerit pas kthimit	
Mbështetje shëndetësore	58.5
Mbështetje për të gjetur vend pune	37.9
Mbështetje për strehim	32.0
Mbështetje arsimore	20.3
Mbështetje për formim profesional	12.0
Tjetër	30.2

**Tabela 27.** Lloji i ofruesit të shërbimit të marrë, (më shumë se një alternativë)

Lloji i ofruesit	
Publik (ofrues shërbimi shtetëror)	27.8
Ofrues shërbimi privat	40.6
Tjetër	44.1

Tabela 28 tregon që vetëm 26.5% e të pyeturve kanë kontaktuar Sportelet e Migracionit për të marrë mbështetje (1.314 persona). Kjo tregon qartë sfidën që kanë Sportelet e Migracionit. Nga kjo përqindje, shumica e të kthyerve kanë marrë direkt nga Sportelet ndihmë për punësim (58% të rasteve) dhe ndërmjetësim (në 42% të rasteve) në shërbime të tjera publike apo private. Aspekt tjetër i rëndësishëm është që Sportelet e Migracionit përbëjnë rreth 50% të mbështetjes së marrë nga ofrues shtetërorë<sup>6)</sup>, që do të thotë se 50% tjetër ka mundur disi që t'i orientojë direkt tek institucionet përgjegjëse.

**Tabela 28.** Kontaktet e të kthyerve me Sportelet e Migracionit, (%)

Kontakte me "Sportele Migracioni"	
Po	26.5
Jo	73.5
Gjithsej	100

Shërbimi më i rëndësishëm i ofruar nga Sportelet e Migracionit është mbështetja për të gjetur vend pune (58%).

**Tabela 29.** Lloji i mbështetjes të marrë nga Sportelet e Migracionit, (%)

Lloji i mbështetjes	
Mbështetje për të gjetur vend pune	58.0
Mbështetje tjetër	42.0
Gjithsej	100.0

<sup>6)</sup> Në terma absolute, 2826 persona kanë marrë mbështetje nga ofrues shtetërorë.


Tabela 30 tregon që tërësia e informacionit të kërkuar në Sportelet e Migracionit është rritur nga viti 2009 në vitin 2010, është ulur në vitin 2011 dhe është rritur ndjeshëm në vitin 2012 (përqindja më e lartë). Në vitin 2013, numri i përdoruesve ka rënë përsëri, por është përsëri më i lartë se numri i tyre përpara vitit 2012. Ky është tregues i efikasitetit në rritje të shërbimeve të ofruara në Sportelet e Migracionit.

**Tabela 30.** Informimi i të kthyerve për Sportelet e Migracionit sipas vitit të kthimit, (%)

Informacion për SM sipas vitit	
2009	14.5
2010	17.1
2011	10.2
2012	33.3
2013	24.9
Gjithsej	100

Të kthyerit nga Greqia dhe Italia janë përdoruesit më të shpeshtë të Sporteleve të Migracionit. Në terma absolute, të kthyerit nga Greqia i kanë përdorur më shumë Sportelet e Migracionit sesa të kthyerit nga Italia, por nëse e krahasojmë këtë me përqindjen e përgjithshme të të kthyerve në përgjithësi (Greqi 61%- Itali 32.7%) mund të vërejmë një numër më të lartë të të kthyerve nga Italia për të marrë informacionin e duhur. Kjo ndoshta është për faktin që mjetet e informacionit për Sportelet e Migracionit kanë qenë më efikase për këtë kategori të të kthyerve.

**Figura 23.** Informacion për SM sipas vendit të emigracionit, (%)




## Ri-emigracioni

32.6% e të kthyerve synojnë të ri-emigrojnë. Në thelb kjo ndodh për shkak të problemeve të evidentuara më sipër. Përgjigja e dytë më e shpeshtë është "ndoshta". Duket se të dy faktorët mund të ndikojnë në vendimet e të fundit: situata ekonomike në vendin e destinacionit dhe të origjinës. Në shifra absolute, megjithatë, më pak se 2/3 e të kthyerve kanë preferuar që t'i përgjigjen kësaj pyetjeje, duke konfirmuar pasigurinë e përgjithshme të marrjes së një vendimi të tillë.



**Figura 24.** Të kthyerit sipas synimit për qëndrim në Shqipëri, (%)



Arsyeja më e zakonshme për ri-emigrim është në fakt e lidhur me shkallën e integrimit të të kthyerve në vendin e fundit të emigracionit. Në paragrafët e mësipërm (5.5), vetëm 5% e të pyeturve evidentuan problemet e integrimit në shoqërinë pritëse. Tabela 31 tregon qartë që 67.3% e të kthyerve dëshiron të ri-emigrojnë në vendin e imigracionit që njih më mirë. Një tjetër konsideratë e rëndësishme është që arsyet shtytëse për ri-emigracion (papunësia/e ardhmja e munguar në vendin e origjinës) janë më të forta sesa arsyet tërheqëse (mundësi të reja punësimi). Këto të dhëna konfirmojnë edhe një herë që shërbimet e ri-integrimit të prera për këtë kategori, së bashku me situatën e përmirësuar të vendit, mund të ndikojnë pak në vendimin e të kthyerve për të ri-emigruar.

**Tabela 31.** Arsyet për ri-emigrim, (më shumë se një alternativë)

Arsye për ri-emigrim	
E njoh tashmë vendin e emigracionit dhe dua të jetoj/ qëndroj atje më gjatë	67.3
Nuk gjej vend pune këtu	56.5
Nuk kam të ardhme në vendin tim	48.3
Për të rinovuar dokumentet e mia	33.5
Mundësi të reja punësimi jashtë vendit	32.3
Nuk e gjej veten në vendin tim	13.5
Tjetër	14.3





# 5

## KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME



## KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në këtë seksion përmbledhen gjetjet kryesore të vrojtimit dhe konkluzionet që dalin si nga studimi i literaturës ashtu edhe nga vrojtimi në terren.

### *Dinamika e kthimit*

- Gjetjet e vrojtimit konfirmojnë përsëri gjetjet e punëve të tjera kërkimore të realizuara për arsyet e emigracionit shqiptar. Rezulton që tre faktorët shtytës për emigracionin në dekadën e mëparshme kanë qenë: papunësia, mundësia për punë më të mira jashtë vendit dhe mundësia për të ardhura më të larta. Gjithashtu, bashkimi familjar dhe pasiguria në përgjithësi në vend përbëjnë faktorë të rëndësishëm shtytës për emigracionin e shqiptarëve.
- Kthimet në Shqipëri janë rritur që në vitin 2009 me shumicën e kthimeve që bëhen nga Greqia dhe Italia. Në Shqipëri në periudhën 2009-2013 janë kthyer gjithësej 133.544 migrantë shqiptarë, prej të cilëve 98.414 meshkuj dhe 35.130 femra. Kjo gjetje tregon nevojën për vazhdimin e studimit të migracionit të kthimit në Shqipëri në vitet e ardhshme, me qëllim që të analizohen trendet e migracionit të kthimit dhe ndikimi i mundshëm mbi të kthyerit, familjet e tyre dhe komunitetin ku vendosen ata, si edhe ndikimi i migracionit të kthimit në kapacitetet institucionale për ri-integrim.
- Shumica e kthimeve për në Shqipëri ka qenë vullnetare dhe ka ndodhur nga Greqia dhe Italia për shkak se migrantët në këto vende kanë humbur punën si pasojë e krizave financiare që kanë goditur këto vende. Megjithatë, vrojtimi nuk mund të tregojë nëse kriza ka ndikuar në lëvizshmërinë për punë të migrantëve shqiptarë, përveç disa të dhënave të kufizuara që mungesa e mundësive për ri-integrime në Shqipëri mund të shërbejë si faktor shtytës për ri-emigrimin e të kthyerve. Kështu, dinamika e kthimit dhe ri-integrimit në Shqipëri kundrejt lëvizshmërisë së migrantëve të punës nga Shqipëria drejt vendeve fqinjë, meriton kërkim të mëtejshëm.
- Shumica e të kthyerve kthehen në vendin e tyre të banimit përpara emigrimit. Megjithatë, migracioni i kthimit në Shqipëri është i lidhur gjithashtu me migracionin e brendshëm të popullsisë. Tendanca e të kthyerve është që të vendosen në qarqet me zhvillim të lartë social-ekonomik ku mund të realizojnë planet e tyre të jetës. Ndër to, Tirana është qarku më i preferuar. Të kthyerit nga Greqia, përveç Tiranës, vendosen kryesisht në Vlorë, Elbasan, Fier dhe Korçë, ndërsa ata nga Italia vendosen kryesisht në Shkodër, Lezhë, Durrës dhe Dibër. Të kthyerit nga Greqia janë të prirur për lëvizshmëri të brendshme pas kthimit. Këto gjetje tregojnë nevojën për të analizuar me më shumë kujdes demografinë e migracionit të kthimit.

### *Ndikimi i kthimit*

- Vrojtimi nuk paraqet ndonjë ndikim të ndjeshëm të emigracionit apo migracionit të kthimit në nivelin arsimor të migrantëve përveç një rënieje në pjesëmarrjen në formim profesional pas kthimit. Kjo gjetje mund të shpjegohet pjesërisht me arsyet e migracionit, që kryesisht mbeten punësimi në vendin e destinacionit dhe mundësi më të mira financiare, dhe jo ndjekja e arsimimit të mëtejshëm.
- Edhe pse objektivi i vrojtimit janë popullata "e rritur" e të kthyerve (18 vjeç e mbi 18 vjeç), gjetjet e tij tregojnë që moshë mesatare e segmentit në kohën e emigracionit ka qenë 30,7 vjeç dhe në kohën e vrojtimit 38,3 vjeç, kështu që të kthyerit i përkasin segmentit të forcës më aktive të punës. Prandaj është e rëndësishme që të eksplorohet më tej ndikimi i kthimit mbi tregun e punës në Shqipëri, si edhe ndikimi i mundësisë së punësimit në vendimin për të qëndruar në Shqipëri ose për të ri-migruar. Vrojtimi tregon se situata e punësimit të përhershëm nuk ka ndryshuar shumë nga ajo përpara migracionit në kohën e vrojtimit. Ndryshe nga kjo, situata e vetë punësimit ka ndryshuar. Kjo tregon që të kthyerit janë të zellshëm për të investuar njohuritë, aftësitë dhe kapitalin financiar të fituar jashtë vendit në veprimtari që gjenerojnë të ardhura. Ky është tregues për ofruesit e shërbimeve të ri-integrimit që të përmirësojnë shërbimet në lidhje me hapjen e bizneseve të reja.
- Rritja e punësimit në sektorin e bujqësisë vërehet pas migracionit. Kjo tregon që të kthyerit po investojnë në bujqësi për veprimtari që gjenerojnë të ardhura. Kjo gjetje shërben edhe një herë si "sinjal" për ofruesit e shërbimeve të ri-integrimit që të përmirësojnë shërbimet në lidhje me punësimin dhe investimin në sektorin e bujqësisë me qëllim që të maksimizohet mundësia e zhvillimit për migracionin e kthimit.
- Në terma investimi pas kthimit, vetëm 8 përqind e të kthyerve ka arritur të realizojë një projekt investimi në Shqipëri, sidomos në tregtinë me pakicë, hoteleri, restorante dhe bujqësi. Për shumicën e investimeve, të



kthyerit janë mbështetur kryesisht në kursimet e tyre, ndonjëherë në kredi bankare dhe tek prindërit ose të afërmit. Arsyet kryesore për mungesën e një projekti investimi është kapitali i pamjaftueshëm dhe prandaj shumica e të kthyerve të këtij segmenti të popullsisë kërkon lehtësimin e procedurave administrative të biznesit dhe përfitime tatimore/ulje taksash për të inkurajuar investimet nga të kthyerit.

#### *Tendenca e ri-emigrimit kundrejt qëndrueshmërisë së kthimit*

- Sa i përket tendencës për të qëndruar në vendin e origjinës ose për të ri-emigruar, duhet të konsiderohet që **financat** janë tregues kyç i arsyes që qëndron pas procesit vendimmarrës të migrantit. Sipas vërtimit, përpara migrimit jashtë vendit, situata financiare e migrantëve ka qenë ose jo e mirë ose shumë e keqe, por është përmirësuar ndjeshëm gjatë qëndrimit jashtë vendit. Megjithatë, pas kthimit në Shqipëri, shumica e të kthyerve shohin situatën e tyre financiare të pandryshuar. Një përqindje e konsiderueshme (32.6 %) e të kthyerve kanë si synim të emigrojnë përsëri për shkak të vështirësive në sigurimin e të ardhurave të mjaftueshme për familjet e tyre. Rrjedhimisht, për të analizuar më mirë sjelljen e të kthyerve pas kthimit dhe vendimmarrjen e tyre në lidhje me kthimin e përhershëm ose ri-emigrimin, është e rëndësishme që të vëzhgohet ndryshimi i situatës financiare të të kthyerve me kohën, ndoshta pas më shumë se një viti. Gjithashtu, shërbimet e ri-integrimit të prera për këtë kategori, së bashku me situatën e përmirësuar të vendit, mund të ndikojnë pak në vendimin e të kthyerve për të ri-emigruar.
- **Ekzistenca e shërbimeve** është gjithashtu një faktor i rëndësishëm që ndikon në vendimin për të qëndruar në Shqipëri ose për t'ju kthyer mundësisë së ri-emigrimit. Sipas vërtimit shumë pak të kthyer kanë marrë ndihmë pas kthimit të tyre në Shqipëri dhe kur kjo ka ndodhur ata më së shumti u janë drejtuar ofruesve të shërbimeve private. Mungesa e shërbimeve të duhura dhe sistemi shëndetësor i papërshtatshëm janë dy faktorë kyç në vendimin për të migruar përsëri. Këto gjetje përforcojnë nevojën për shërbime më efektive ri-integrimi në përgjithësi dhe në veçanti nga shërbimet publike sipas nevojave të të kthyerve.

Sipas vërtimit shumica e të kthyerve nuk kanë dijeni për Sportelet e Migracionit në vend dhe shërbimet që ato ofrojnë në mbështetje të ri-integrimit të të kthyerve në vendin e tyre. Ky konstatim tregon qartë sfidat me të cilat përballen akoma Sportelet e Migracionit për të arritur grupet e synuara. Sidoqoftë, duke qenë se Sportelet kanë filluar funksionimin e tyre në Korrik 2010, kjo gjetje kërkon analizim të mëtejshëm si dhe monitorim të situatës së regjistrimit në Sportelet e Migracionit në vijimësi.



# 6

## BIBLIOGRAFIA



## BIBLIOGRAFIA

- Agunias D. Rannveig (2006), *"From a Zero-Sum to a Win-Win Scenario?"*, Migration Policy Institute
- Black R. (2004), *Understanding Voluntary Return*, Home Office Online Report 50/04, Sussex Centre for Migration Research
- Cassarino J.P. (2008) *"Return migrants to the Maghreb countries reintegration and development challenges"*, Jean-Pierre Cassarino (Ed.), 2008, European University Institute, Robert Schuman Center for Advanced Studies
- Cassarino J.P. (2014), *"Reintegration and development"*, Jean-Pierre Cassarino (Ed.), 2014, European University Institute, Robert Schuman Center for Advanced Studies
- Komisioni i Komuniteteve Europiane, *Propozim për një Direktivë të Parlamentit Europian dhe të Këshillit për Standardet dhe Procedurat e Përbashkëta në Shtetet Anëtare në lidhje me Kthimin e Shtetasve të Vendeve të Treta me Qëndrim të Paligjshëm*, Komunikatë e Komisionit, COM(2005) 391 final, Bruksel, 1 shtator 2005.
- Fondacioni Europian për Trajnimin (ETF) (2007). Kontributi i zhvillimit të burimeve njerëzore në politikën e migracionit, Shqipëri.
- Gemi, E. (2013) *"Albanian Irregular Migration to Greece: A new typology of crises."* Background Report Migration System 1 (Albania), Hellenic Foundation for European and Foreign Policy (ELIAMEP)
- Gmelch, G. (1980), *Return Migration*, Annual Review of Anthropology, 9:135-159
- Grazhdani, T. (2013) *Institutionalizing Assistance to Returning Migrants. Lessons Learned from the Albanian Experience.* European Scientific Journal 9, 32, p. 281-296.
- INSTAT (2011), *Migracioni në Shqipëri, Regjistrimi i popullsisë dhe i banesave.*
- INSTAT (2004). *Migracioni në Shqipëri*
- Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (2000), King R., (2000), *Përgjithësime nga Historia e Migracionit të Kthimit*, në *"Return Migration: Journey of Hope or Despair"* redaktuar nga Bimal Ghosh
- Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (2006a). *Kthimi dhe Ripranimi: Rasti i Shqipërisë.* IOM, Tiranë: Shqipëri.
- Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (2006b). *Institucionalizimi i asistencës për migrantët e kthyer në Shqipëri përmes zyrave lokale të punësimit dhe OJQ-ve lokale.* IOM, Tiranë: Shqipëri.
- Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (2008), *"Identifikimi i zonave të prekura nga emigracionit dhe migracioni i kthimit në Shqipëri: Profili i migrantëve të kthyer"*. IOM, Tiranë: Shqipëri.
- Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (2011), *Fjalorth për Migracionin*, Botimi i 2të, nr 25, International Migration Law, Richard Perruchoud and Jillyanne Redpath-Cross, eds







**7**

**ANEKSET**



## ANEKS 1: FJALORTH

**Kapital financiar:** Fonde dhe remitanca të marra nga migranti.

**Kthim i detyruar është** kthimi i detyruar i një individi në vendin e origjinës, tranzitit apo në një vend të tretë, mbi bazën e një akti administrativ apo gjyqësor.

**Kapital njerëzor:** Aftësi, ekspertizë, trajnim dhe vlera të reja të fituara nga migrantët të cilat bëjnë të mundur që ai/ajo të veprojë ndryshe.

**Njësi Ekonomike Familjare:** i referohet grupit të personave që qëndrojnë së bashku në një shtëpi dhe që kanë ekonomi pjesërisht ose plotësisht të përbashkët.

**Vendi kryesor i emigracionit/destinacionit:** i referohet vendit të fundit të imigrimit ku ka jetuar i intervistuari përpara kthimit në vendin e origjinës.

**Kthim i përhershëm:** i referohet kthimit në vendin e origjinës për periudhë afatgjatë.

**Kushte pas kthimit:** Faktorë dhe rrethana të veçanta për përvojën e pas kthimit të migrantit në vendin e origjinës, qoftë kur kthimi është i përkohshëm apo i përhershëm.

**Kushte para-kthimit:** Faktorë dhe rrethana të veçanta për përvojën e migracionit të migrantit, përpara kthimit në vendin e origjinës.

**Re-emigrim:** Kur një i kthyer ri-emigron, ai ose ajo largohet përsëri jashtë vendit të paktën tre muaj pas kthimit në vendin e origjinës.

**Person reference:** është anëtari që përgjithësisht merr vendimet kryesore në njësinë ekonomike familjare dhe që njihet si i tillë nga të gjithë anëtarët e familjes. Në shumë raste, në një njësi ekonomike familjare që përbëhet nga një çift me fëmijë të pamartuar, babai njihet si person reference.

**Ri-integrim:** Ripërfshirje apo ritrupëzimi i një personi në një grup ose proces, p.sh. një migrant në shoqërinë e vendit të tij të origjinës ose të qëndrimit të zakonshëm.

- a) Ri-integrim (*kulturore*): Në kontekst të migracionit të kthimit, ripërshtatje e migrantit të kthyer me vlerat, mënyrën e jetesës, gjuhën, parimet morale, ideologjisë dhe traditave të shoqërisë së vendit të origjinës.
- b) Ri-integrim (*ekonomik*): Në kontekst të migracionit të kthimit, procesi nëpërmjet të cilit, migranti ripërfshihet në sistemin ekonomik të vendit të tij/saj të origjinës dhe i ofrohet mundësia të fitojë vetë jetesën. Në terma të zhvillimit, ri-integrimi ekonomik synon edhe shfrytëzimin e njohurive që ka marrë në vendin e huaj për nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit të origjinës.
- c) Ri-integrim (*social*): Në kontekst të migracionit të kthimit, ripërfshirje e një migranti në strukturat shoqërore të vendit të tij/saj të origjinës. Kjo përfshin nga njëra anë krijimin e një rrjeti personal (miq, të afërm, fqinjë) dhe nga ana tjetër zhvillimin e strukturave të shoqërisë civile (shoqata, grupe të vetë-mbështetjes dhe organizata të tjera).

**Mobilizim i burimeve:** Procesi nëpërmjet të cilit një migrant mbledh burimet, të prekshme apo jo, përpara dhe pas kthimit. Ky proces është pjesë e përgatitjes për kthim.

**Migracioni i kthimit:** Lëvizja e një personi që kthehet në vendin e tij/saj të origjinës ose banimit të zakonshëm pasi kalon të paktën një vit në një vend tjetër. Ky kthim mund të jetë vullnetar ose jo. Migracioni i kthimit përfshin riatdhesimin vullnetar.

**Përgatitja për kthim:** Procesi që zhvillohet në kuadër të kthimit në vendin e origjinës. Ekzistojnë nivele të ndryshme të përgatitjes për kthim që trajtojnë ri-integrimin social dhe profesional të migrantit dhe ripërshtatjen në vendin e origjinës.

**Kthim vullnetar:** Kthimi i asistuar ose i pavarur në vendin e origjinës, tranzitit ose në një vend të tretë në bazë të vullnetit të lirë të të kthyerit.

**Vendbanim i zakonshëm<sup>7</sup>:** do të thotë vendi ku personi kalon normalisht periudhën e përditshme të qëndrimit, pavarësisht mungesave të përkohshme për qëllim argëtimi, pushimi, vizitash tek miqtë ose të afërmit, pune, trajtimi

<sup>7</sup> Rregullore e Komisionit (EC) nr 1202/2009.



shëndetësor, apo pelegrinazh fetar. Vetëm personat e mëposhtme do të konsiderohen banorë të zakonshëm të një zone të caktuar gjeografike:

- a) Ata që kanë jetuar në vendin e banimit të zakonshëm për një periudhë të vazhdueshme të paktën 12 muajve përpara kohës së referencës;
- b) Ata që kanë mbërritur në vendin e banimit të zakonshëm gjatë 12 muajve përpara kohës së referencës me synim për të qëndruar aty të paktën një vit.

## ANEKS 2. PROFILI I TË KTHYERIT

Shumica e të kthyerve (61%) i përket grupmoshës **18-40 vjeç**. Në këtë segment:

- Kthimet janë veçori dalluese e meshkujve (77.7%) që kanë ikur nga Shqipëria pas vitit 2007 dhe kanë vendosur të kthehen në vendin e tyre me nismën e tyre. Shumica e tyre (61.3%) janë kthyer në vendin e tyre të lindjes/vendbanimit të zakonshëm përpara migracionit.
- Moshë mesatare e këtij segmenti është 22 vjeç në kohën e emigrimit dhe 28 vjeç në kohën e vrojtimit. Ata kanë jetuar jashtë vendit për një periudhë 5 vjeçare dhe 23 përqind e tyre kanë qëndruar për 2 vjet në vendin e fundit të emigrimit.
- Shumica ka emigruar në Greqi (66%) për shkak të afërsisë gjeografike, hyrjes më të lehtë në vend dhe mundësive të punësimit dhe gjithashtu për shkak të pranisë së familjes/miqve (16%).
- Gjysma e popullsisë së këtij segmenti ka migruar pa dokumente të rregullta, 40 përqind me dokumente të rregullta dhe 8.6 përqind me dokumente të falsifikuara. Në 70 përqind të rasteve, familja e ka mbështetur udhëtimin e migrimin.
- Shumica e migrantëve në kohën e emigrimit kanë qenë beqar (72%) dhe vetëm 11 përqind kanë pasur fëmijë. Megjithatë, kjo përqindje ka ndryshuar ndjeshëm gjatë emigrimit dhe pas kthimit. 14 përqind janë martuar në vendin pritës, 51 përqind e të cilëve kanë pasur fëmijë. 13.3 përqind e migrantëve janë martuar pas kthimit.
- Shumica e migrantëve kishin përfunduar ose nivelin arsimor fillor (49.7%) ose të mesëm (39%); 21 përqind e tyre mund të flasë relativisht shumë mirë një gjuhë të huaj. Vetëm 13.3 përqind e migrantëve ka ndjekur studime të mëtejshme jashtë vendit dhe 7.8 përqind formim profesional.
- Sa i përket statusit të punësimit, 65.6 përqind e migrantëve nuk ka pasur punë përpara migrimin, vetëm 10 përqind kanë qenë të punësuar dhe të vetë-punësuar dhe 19 përqind kanë qenë studentë. Një total prej 46 përqind kanë pasur punë ose kanë qenë të vetë-punësuar në vendin e fundit të emigracionit përpara kthimit, 61 përqind kanë gjetur punë brenda 3 muajve të parë jashtë vendit. Me të mbërritur në Shqipëri vetëm 23 përqind e të kthyerve janë punësuar ose vetë-punësuar, ndërsa në kohën e vrojtimit 33.5 përqind janë punësuar dhe 20.3 përqind janë vetë-punësuar.
- Arsyeja kryesore e kthimit në Shqipëri është humbja e punës në vendin e fundit të destinacionit, e ndjekur nga malli për vendin dhe traditat si edhe problemet familjare në Shqipëri.
- Shumica e të kthyerve vërejnë keqësim të situatës së tyre financiare pas kthimit, 41 përqind kundrejt 38 përqind deklarojnë që situata e tyre financiare nuk ka ndryshuar.
- Vetëm 7 përqind e popullsisë së këtij segmenti ka arritur të realizojë një projekt investimi në Shqipëri, sidomos në tregtinë me pakicë, hoteleri, restorante dhe bujqësi. Për shumicën e investimeve, ata kanë financuar vetë, në 99 përqind të rasteve, ndërsa 18 përqind kanë përdorur kreditë bankare dhe 12 përqind huatë nga prindërit ose të afërmit.
- Situata sociale dhe ekonomike në Shqipëri ndikon direkt në vendimin për të qëndruar në vend ose për t'ju kthyer mundësisë së ri-emigrimit. Përpara udhëtimin jashtë vendit, vetëm 12 përqind e migrantëve ka deklaruar që ka pasur synimin që të qëndrojë jashtë vendit përgjithmonë, 48 përqind përkohësisht, ndërsa 40 përqind nuk e dinin në kohën e intervistimit. Pas kthimit, 31 përqind e të kthyerve deklaroi se ka synimin që të ri-emigrojë përsëri dhe nga kjo përqindje, 47 përqind e tyre do të kthehet në vendin e fundit të emigracionit dhe 37 përqind ishin të pasigurt.
- Arsyeja kryesore e ri-emigrimit është vështirësia për të gjetur mundësi punësimi në më shumë se 70 përqind



të rasteve. Të kthyerit (60%) përballen me një sërë sfidash në Shqipëri si mungesa e shërbimeve të duhura të ri-integrimit dhe të ardhura të pamjaftueshme. Më pak se 5 përqind e këtij segmenti të të kthyerve ka marrë ndihmë pas kthimit në Shqipëri, ndërsa 4.3 përqind ka pasur dijeni për Sportelet e Migracionit dhe shërbimet e tyre.





ISBN 978-9928-188-13-7



9 789928 188137